



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.legjislacioni.gov.al](http://www.legjislacioni.gov.al)

**Nr. 50**

**Datë 11 prill 2014**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK  
nr. 14, datë 21.3.2014

Me objekt: - Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.”;  
- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”;  
- Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.” .....

2011

Vendim i GJK  
nr. 18, datë 31.3.2014

Me objekt: - Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosarsyetimit të vendimit penal të Gjykatës së Lartë, brenda një afati të arsyeshëm.  
- Shfuqizimi i vendimit të datës 16.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.  
- Dëmshpërblimi në shumën 200 000 lekë nga ana e Gjykatës së Lartë.....

2022

Vendim i GJK  
nr. 19, datë 2.4.2014

Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve: nr. 1126, datë 30.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 190, datë 3.3.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-321, datë 20.3.2012, dhe nr. 00-2012-674, datë 17.5.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....

2027

Vendim i GJK  
nr. 20, datë 4.4.2014

Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”..... 2029

Vendim i GJK  
nr. 21, datë 7.4.2014

Me objekt konstatimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 100, datë 15.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë..... 2039

**VENDIM**  
**Nr. 14, datë 21.3.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 3.10.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare, çështjen nr. 26/4 Akti që i përket:

**KËRKUESE:** Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, përfaqësuar me prokurë nga av. Thimio Kondi dhe av. Alket Hysenaj.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, me autorizim nga z.Armir Juka;

Ministria e Financave, përfaqësuar me autorizim nga znj. Sigita Gjoka;

Autoriteti i Konkurrencës, përfaqësuar me autorizim nga z. Ermal Nazifi;

Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G., përfaqësuar me prokurë nga av. Vangjel Kosta.

**OBJEKTI:** -Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e Kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.”;

- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”;

- Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e Kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.”

**BAZA LIGJORE:** Nenet 11, 118,131/c, dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, e cila kërkoi pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe të Autoritetit të Konkurrencës që e la në çmimin e gjykatës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G. është lidhur një Kontratë koncesioni për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve (Kontrata e koncesionit). Kjo kontratë është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013, dhe ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 52/2013 (VKM nr. 200). Ky vendim është bazuar në nenet 21, pika 4, dhe 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

2. Në datën 27.5.2013, Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve (kërkuesja), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e VKM-së nr. 200, për papajtueshmëri me nenet 11, 118 dhe 155 të Kushtetutës.

3. Në datën 21.6.2013, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, gjatë shqyrtimit paraprak, vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare.

4. Në datën 5.10.2013, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me shtesë objekti, për shfuqizimin e VKM-së nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës” (VKM nr. 498), botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105/2013. Gjykata e pranoi kërkesën për shtesë objekti, prandaj dhe vlerëson të shprehet për të dy vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt gjykimi.

5. Sipas kushteve të Kontratës së koncesionit, së cilës i referohen dy vendimet e Këshillit të Ministrave objekt gjykimi, procesi i shënjimit dhe monitorimit do të realizohet nga Koncesionari. Kjo kontratë është nënshkruar për një periudhë 10-vjeçare (neni 4), duke i dhënë të drejta ekskluzive Koncesionarit, shoqërisë “GFI Albania” sh.p.k., për ofrimin e këtij shërbimi. Po sipas kontratës, Koncesioni është shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve që do të ofrohet nga Koncesionari për qëllime të kontrollit fiskal në Republikën e Shqipërisë, ku shërbimi i markimit konsiston në injektimin e markuesit në produktet e përcaktuara në kontratë, ndërsa shërbimi i monitorimit konsiston në kontrollin për shmangie të evazionit fiskal të subjekteve që janë të detyruara të kryejnë markimin e produkteve të specifikuar në kontratë (neni 1).

## II Pretendimet e palëve

6. *Kërkesja, Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve*, pretendon antikushtetutshmërinë e dy VKM-ve, për këto arsye:

6.1 Detyrimi për të realizuar markimin pranë Koncesionarit, si subjekt i vetëm në treg për këtë shërbim, cenon konkurrencën dhe krijon pozitë dominuese në treg. Shteti, me ligj, mund të krijojë situatë monopol të një veprimtarie ekonomike të ushtruar prej tij, por jo prej privatëve. Është kufizuar liria ekonomike në kundërshtim me nenet 11 dhe 17 të Kushtetutës, që kërkojnë rezervë absolute ligjore dhe, mbi të gjitha, nuk ka arsye të rëndësishme publike mbi këtë lloj kufizimi.

6.2 Janë shkelur marrëveshjet ndërkombëtare, ku vendi ynë ka aderuar dhe i ka ratifikuar, si, OBT-GATT (Marrëveshje e përgjithshme për tregtinë dhe tarifat e Organizatës Botërore të Tregtisë), dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në lidhje me lirinë ekonomike.

6.3 Është shkelur neni 118 i Kushtetutës, sepse dhënia e koncesionit një subjekti të vetëm, në kushtet e monopolit, bie në kundërshtim me përcaktimet mbi procedurën që duhet ndjekur nga Këshilli i Ministrave për ngjyrimin, sipas nenit 54/4 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

6.4 Është shkelur neni 155 i Kushtetutës, pasi tarifa për shërbimin e shënjimit, si pagesë e detyrueshme për tregtuesit, është detyrim financiar i karakterit normativ, prandaj dhe duhej përcaktuar me ligj dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit*, ka argumentuar se:

7.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion kushtetues, sepse VKM-ja nr. 200 është akt individual. Kjo VKM nuk ka bërë rregullim të përgjithshëm, pasi çmimi dhe termat e tjera janë rregulluar nga Kontrata e koncesionit.

7.2 Liria ekonomike nënkupton importimin, magazinimin, eksportimin dhe tregtimin e produkteve të hidrokarbureve, gjë që nuk është cenuar apo kufizuar me këto vendime. Shënjimi, në vetvete, nuk ia kufizon këtë liri veprimi subjekteve. Edhe nëse pranojmë që ka kufizim të veprimtarisë ekonomike, ky kufizim është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës, pasi shënjimi është realizuar për shmangien e evazionit fiskal që është në interes publik.

7.3 VKM-të objekt gjykimi nuk bien në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, por, përkundrazi, respektojnë disa nga parimet më të rëndësishme të përcaktuara nga kjo marrëveshje, përkatësisht nenet 76, 85, 98 dhe 108 (shmangia e evazionit, qëndrueshmëri mjedisore, masa të reja efikase fiskale).

7.4 Markimi përcaktohet nga ligji nr. 61/2012 “Për akcizat”, prandaj dhe subjekti nuk mund të kundërshtojë VKM-të, pasi nëse ka kufizim, ky është bërë me ligj.

7.5 VKM-ja nr. 498 përcakton një tarifë fikse për shërbimin e shënjimit, e cila është përcaktuar nga Kontrata e koncesionit, sipas rregullave të së drejtës civile. Në këtë kuptim, kjo VKM nuk ka vendosur taksë, prandaj dhe garancitë e nenit 155 të Kushtetutës, nuk mund të zbatohen.

8. *Subjekti i interesuar, Ministria e Financave*, ka paraqitur këto argumente:

8.1 Kërkesja nuk legjitimohet, sepse përderisa dy VKM-të nuk kanë përcaktime që të cenojnë lirinë ekonomike, kjo do të thotë se nuk ka dëm potencial, si kriter legjitimimi për shoqatat.

8.2 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion në lidhje me VKM-në nr. 200, sepse është e karakterit individual.

8.3 Liria ekonomike, si koncept kushtetues, nuk nënkupton lirinë për t’iu shmangur kontrolleve shtetërore, pra në rastin konkret edhe kontrolleve nëpërmjet instrumentit të shënjimit dhe monitorimit, prandaj dhe VKM-ja nr. 498 nuk e cenon nenin 11 të Kushtetutës.

8.4 Tarifa për shërbimin e shënjimit, nuk është taksë kombëtare apo pagesë kombëtare, por kosto e implementimit të instrumentit të markimit, e përcaktuar me kontratë sipas ligjit për koncesionet. Për rrjedhojë, kjo pagesë nuk është caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk ka pse të pretendohet dhe përcaktimi me ligj.

9. *Subjekti i interesuar, Autoriteti i Konkurrencës*, ka paraqitur këto parashtrime:

9.1 Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” përcakton në nenin 69/b, detyrimin për organet e administratës qendrore dhe vendore të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt /akt normativ, që ka të bëjë me vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara. Autoriteti vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga këto projektakte. Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar Ministrisë së Financave informacion për vlerësimin *ex ante* të koncesionit të markimit, detyrim të cilin kjo ministri nuk e ka plotësuar.

9.2 Për të vlerësuar praktikën, nëse është antikonkurrese dhe nëse ka abuzim me pozitën dominuese në treg, ky hetim *ex post* mund të kryhet eventualisht vetëm pasi të ketë filluar veprimtaria e dhënë me koncesion dhe të jenë vënë re shenja të kufizimit të konkurrencës.

10. *Subjekti i interesuar, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.*, ka argumentuar se:

10.1 Kërkesja nuk legjitimohet, sepse përderisa VKM-të nuk kanë përcaktime që të cenojnë lirinë ekonomike, kjo do të thotë se nuk ka dëm potencial, si kriter legjitimimi për shoqatat.

10.2 VKM-ja nr. 200 ka miratuar një Kontratë koncesioni, prandaj është akt individual dhe rrjedhimisht jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

10.3 VKM-ja nr. 498 nuk cenon lirinë ekonomike, sepse lënda e parë e procedurës së markimit (ngjyruesi) nuk mund të shihet si mall tregtar, por si element i rëndësishëm i procesit të kontrollit të shënjjimit.

### III Vlerësimi i Gjykatës

#### *Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 200*

11. Mbledhja e Gjyqtarëve mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të VKM-së nr. 200, objekt shqyrtimi. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, subjekti që kërkon pezullimin e një akti duhet të provojë prekjën e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si dhe pasojat e pariparueshme që do të sillte zbatimi i aktit. Mbledhja e Gjyqtarëve nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi. Për këtë arsye, në datën 27.6.2013, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave. Kërkesja përsëriti kërkesën për pezullim edhe në seancë gjyqësore, prandaj dhe Gjykata, me vendimin e ndërmjetëm të datës 3.10.2013, u shpreh për rrëzimin e kërkesës për pezullim të vendimit nr. 200, datë 13.3.2013, të Këshillit të Ministrave, me të njëjtin argument.

#### *Për legjitimitimin e kërkuarës, Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve*

12. Çështjen e legjitimitimit Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

13. Për sa i përket legjitimitimit të shoqatave, si subjekte iniciuese sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të

individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkesja pretendon se VKM-ja nr. 200 dhe VKM-ja nr. 498 përcaktojnë detyrime mbi subjektet tregtare në fushën e hidrokarbureve, në lidhje me procedurat e shënjjimit të hidrokarbureve kundrejt një tarife fikse, që, për pasojë, do të rriste çmimin e tyre dhe do të sillte uljen e fitimit. Njëkohësisht, kërkesja pretendon se shënjjimi është një shërbim, i cili mund të kryhet nga tregtuesit e hidrokarbureve, në kuadër të lirisë ekonomike për të përzgjedhur subjektin e shënjjimit, ndërsa VKM-ja nr. 498 përcakton një subjekt të vetëm koncesionar. Sipas subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G., kërkesja nuk legjitimohet, sepse nuk ka cenim të lirisë ekonomike, që do të thotë se nuk ka dëm potencial si kriter i domosdoshëm për legjitimitimin e shoqatave.

15. Gjykata konstaton se Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 810, datë 28.10.2003. Anëtarët e shoqatës janë shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe pakicë të hidrokarbureve në Shqipëri. Në statutin e shoqatës parashikohet, ndër të tjera, se qëllimi kryesor i shoqatës është “...përfaqësimi, dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta të anëtarëve në kuadrin e zhvillimit të tregut të hidrokarbureve”.

16. Gjykata vlerëson se shoqata mbron interesat kushtetuese të personave juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e hidrokarbureve dhe ka argumentuar mjaftueshëm *prima facie* se interesat e tyre kontraktuale dhe fitimprurëse preken nga zbatimi i VKM-ve. Për rrjedhojë, kërkesja ka legjitimitim *ratione personae* në këndvështrim të nenit 134/2 të Kushtetutës<sup>1</sup>. Gjithashtu, kërkesja ka edhe legjitimitim *ratione temporis*, sepse vendimet objekt gjykimi janë brenda afatit 3-vjeçar ligjor për t’u kundërshtuar para Gjykatës Kushtetuese, në

<sup>1</sup>Votuan kundër legjitimitimit gjyqtarët: V. Kristo, V. Tusha, A. Xhoxhaj, G. Dizdari.

përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

17. Sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata çmon të shprehet për vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt gjykimi, veç e veç, sepse nga palët e interesuara janë ngritur pretendime që kanë lidhje me karakterin e VKM-së nr. 200 dhe, për rrjedhojë, dhe me juridiksionin e Gjykatës.

#### IV

#### **Për juridiksionin e Gjykatës në shqyrtimin e VKM-së nr. 200 dhe VKM-së nr. 498**

18. Kërkuesja ka pretenduar se VKM-ja nr. 200 është akt normativ dhe, për rrjedhojë, dhe brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, si dhe Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G., argumentojnë se Gjykata nuk ka juridiksion kushtetues, sepse VKM-ja nr. 200 është akt individual.

19. Neni 131/c i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuptim të kësaj dispozite, Gjykata thekson se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, që ushtron kjo Gjykatë, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Prandaj dhe Gjykata vlerëson të ndalet paraprakisht tek natyra e VKM-së nr. 200, si dhe në juridiksionin e saj mbi shqyrtimin substancial të këtij akti.

20. Gjykata, gjatë jurisprudencës së saj, ka theksuar se një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh (vendimi nr. 185, datë 26.11.2001, i Gjykatës Kushtetuese). Një akt individual i referohet një fakti konkret dhe jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete, me natyrë teknike dhe jo normative (vendimi nr. 35, datë 7.3.2013, i Mbledhjes së Gjyqtarëve).

21. Akti individual është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete, ndërsa akti normativ, është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të

përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga ligji nr. 49, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

22. Në vlerësimin e Gjykatës, tri kritere përcaktojnë ndarjen e aktit nënligjor në individual ose normativ: i) *Subjektet të cilave akti u drejtohet* - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme, ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; ii) *Objekti-krijimi*, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative, ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes, me karakter abstrakt; iii) *Karakterit shterues/jo shterues*- efektet shtrihen tek subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njehershme, ose tek subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme.

23. Duke analizuar VKM-në nr. 200, sipas tri kritereve të sipërpërmendura, Gjykata çmon se *strictu sensu*, VKM-ja i drejtohet palëve nënshkruese të Kontratës së koncesionit, si subjekte individualisht të përcaktuara. Gjithashtu, objekti i vendimit është konkret, sepse ka për qëllim vetëm miratimin e Kontratës së koncesionit. Efekti i kësaj VKM-je është ekzekutimi i kontratës së koncesionit, duke i dhënë vendimit natyrë shteruese.

24. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Gjykata vlerëson se VKM-ja nr. 200 është një akt individual dhe, si i tillë, nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues, sipas nenit 131/c të Kushtetutës. Për rrjedhojë dhe kërkuesja, Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, nuk legjitimohet për këtë pjesë të kërkimit (*ratione materiae*).

25. Sa i përket VKM-së nr. 498, Gjykata konstaton se kjo VKM detyron për pajisjen me shërbimin e shënjimit, të gjitha subjektet të cilat tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonjë, prodhojnë, rafinojnë, ose kryejnë çdo aktivitet tregtar me produktet, që janë të detyruara të paguajnë detyrimet fiskale për produktet e shënjimit dhe që kërkojnë kryerjen e shërbimit të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës të zotëruara prej tyre, sipas kuadrit ligjor për shërbimin e shënjimit (*pika 1.10 e vendimit*).

26. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 498 i drejtohet të gjithë kategorisë së subjekteve tregtare që veprojnë në fushën e hidrokarbureve, jo në mënyrë nominative, por në mënyrë të cilësuar për shkak të karakteristikave të kësaj kategorie. Kushdo subjekt që i mbart cilësitë, ose do t'i mbartë në të ardhmen, bëhet subjekt me interesa të ligjshme në drejtim të rregullimeve normative të përcaktuara në VKM. Prandaj, Gjykata çmon se nisur nga rrethi i subjekteve që u drejtohet dhe efekteve që do të sjellë mbi to, në mënyrë të përsëritur, VKM-ja nr.

498 ka karakter joshterues. Për rrjedhojë, VKM-ja nr. 498 është akt nënligjor normativ dhe, në kuptim të nenit 131/c të Kushtetutës, është brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

## V

### *Mbi themelin*

*A. Për pretendimin se cenohet liria ekonomike në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës*

27. Kërkesja pretendon para Gjykatës shkeljen e nenit 11 të Kushtetutës, pasi është cenuar liria ekonomike për të realizuar shërbimet sipas zgjedhjes së anëtarëve të saj. Sipas kërkeses, shënjimi mund të bëhet dhe nga vetë anëtarët e Shoqatës së Shoqërive të Hidrokarbureve, pranë rafinerive ku ata furnizohen, dhe më pas strukturat shtetërore kompetente, ose subjekti apo subjektet e përcaktuara nga shteti të bëjnë kontrollin/monitorimin. Po kështu, edhe nëse ndodhemi përballë kufizimit, ai duhej bërë me ligj dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe për një arsye publike të rëndësishme.

28. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, argumenton se liria ekonomike, për anëtarët e shoqatës kërkuese, nënkupton importimin, magazinimin, eksportimin dhe tregtimin e produkteve të hidrokarbureve, liri që nuk është cenuar apo kufizuar me këtë vendim.

29. Kushtetuta, në nenin 11, pikat 1 dhe 3, parashikon se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, dhe se kufizimet e lirisë ekonomike mund të bëhen vetëm me ligj, për një arsye të rëndësishme publike. Gjykata e ka interpretuar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Liria e veprimtarisë ekonomike përban në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimet nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 19, datë 9.7.2009; nr. 24, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata është shprehur, gjithashtu, se liria e veprimtarisë ekonomike përban edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike nga njëra anë dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimet nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 24, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata thekson se në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, praktikat në kundërshtim me nenin 71 (*konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike*) vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos të neneve 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian, dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit. Në këto kushte, ashtu si edhe në gjykime të mëparshme, Gjykata e sheh me vend t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED), lidhur me zbatimin e rregullave të konkurrencës në respektim të kësaj marrëveshjeje.

32. Në çështje të ngjashme, kur një aktivitet i caktuar i është dhënë nga autoriteti publik një shoqërie me të drejta ekskluzive, GJED-ja është shprehur se paraprakisht duhet bërë dallimi mes faktit nëse shteti mund të veprojë duke ushtruar autoritet publik, apo duke ndërmarrë kryerjen e aktiviteteve ekonomike, të natyrës tregtare, industriale, duke prodhuar dhe ofruar mallra dhe shërbime në treg. Me qëllim që të arrihet të bëhet ky dallim, është e nevojshme që në çdo çështje të vlerësohet veprimtaria e ushtruar nga shteti dhe të përcaktohet se cilës kategorie këto aktivitete i përkasin. Kjo gjykatë mbikëqyrjen e aktivitetit të kundërndotjes në portin e Gjenovës, e konsideroi si aktivitet të natyrës joekonomike, për të cilin justifikohet përjashtimi nga rregullat e konkurrencës (*C-343/95, Cali v. Servizi ecologici porto di Genova SpA, perifrazim prg.16-23*). Po kështu, në një çështje tjetër, GJED-ja mbajti qëndrimin se aktivitetet e kontrollit dhe mbikëqyrjes ajrore janë tipike aktivitete të ushtrimit të autoritetit publik dhe, si të tilla, ato nuk janë të natyrës ekonomike që të detyrojnë zbatimin e rregullave të konkurrencës

(C-364/92, *SAT Fluggesellschaft mbH v Eurocontrol*, prg.30). GJED-ja është shprehur se dispozita e nenit 90/2 të Traktatit u lejon shteteve që sipërmarrjeve që u ngarkojnë realizimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik, t'u akordojnë të drejta ekskluzive të cilat mund të pengojnë zbatimin e rregullave të Traktatit për konkurrencën, për sa kufizimet e konkurrencës, ose edhe përjashtimi i gjithë konkurrencës, nga operatorët e tjerë ekonomikë, janë të nevojshme për të siguruar kryerjen e detyrave specifike që u janë ngarkuar sipërmarrjeve të pajisura me të drejtat ekskluzive (C-320/91, *Paul CORBEAU*, prg.14).

33. Gjykata vëren se vendimi i Këshillit të Ministrave, objekt shqyrtimi, në bazë të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", ka inkorporuar në nenet e tij, një kontratë konkrete koncesioni, të lidhur midis autoritetit kontraktues, Ministrisë së Financave, dhe koncesionarit, subjekti i interesuar. Kjo kontratë ka për objekt projektimin, ngritjen dhe vënien në zbatim të një sistemi kombëtar për "Markimin dhe monitorimin e karburanteve në Republikën e Shqipërisë", i cili do të krijojë mundësinë e identifikimit të përzierjeve të paligjshme të karburanteve qarkulluese në tregun shqiptar, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve fiskale. Me sistemin kombëtar të "Markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë", vërtetohet jo vetëm nëse përbërja e karburanteve ka ndryshuar mbas pagesës së detyrimeve fiskale, por edhe nëse karburanti në qarkullim është i markuar, pra i ka paguar këto detyrime.

34. Gjykata vlerëson se ndërhyrja e shtetit nëpërmjet shënjitimit dhe monitorimit bëhet me synim shmangien e evazionit fiskal, kontrollin më cilësor të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe disiplinimin e veprimtarisë në tregun e hidrokarbureve, si politikë shtetërore me interes publik. Gjithashtu, përveç qëllimit kryesor për të cilin Këshilli i Ministrave ka vendosur detyrimin e shënjitimit dhe monitorimit, ky proces ka edhe dobi të tjera me interes të përgjithshëm si, ngushtimin e hapësirave për veprime korruptive, përmirësimin e cilësisë së karburanteve, si dhe uljen e ndotjes ambientale.

35. Në këto kushte, subjekti koncesionar është ngarkuar nga ana e shtetit me kryerjen e një shërbimi të një interesi të përgjithshëm, që konsiston në kryerjen e shënjitimit në produktet e naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës dhe monitorimin e këtij procesi, mbi tarifa uniforme dhe kushte cilësie të njëjta. Ky proces është i lidhur për nga natyra, qëllimi dhe rregullat e përcaktuara mbi finalizimin e këtij procesi, me ushtrimin e pushtetit publik me qëllim shmangien e evazionit fiskal, funksion tipik i autoriteteve shtetërore. Për më tepër, duke qenë se procesi i shënjitimit dhe monitorimit është në tërësi instrument kontrolli kundër abuzimeve në sistemin fiskal, është në diskrecionin e

ekzekutivit të vlerësojë nëse duhet të realizohet nga vetë shteti apo nga një subjekt i kontraktuar. Duke qenë shërbime specifike, që lidhen me realizimin e një interesi të përgjithshëm, Gjykata vlerëson se përjashtimi i tyre nga rregullat e konkurrencës nuk përbën cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

36. Gjithashtu, Gjykata thekson se VKM-ja nr. 498 nuk ka për objekt rregullimi veprimtarinë e prodhimit, eksportimit, importimit, shpërndarjes, transportit apo shitjes me pakicë dhe shumicë të hidrokarbureve, të cilat janë veprimtari që ushtrohen nga ana e anëtarëve të shoqatës kërkuese. Këshilli i Ministrave nuk ka ndërhyrë për të rregulluar veprimtari tregtare në këtë fushë, çka mund të ngrinte dyshime lidhur me cenimin e nenit 11 të Kushtetutës, por ka pasur si qëllim mbledhjen e të ardhurave tatimore, shmangien e evazionit fiskal dhe mbikëqyrjen dhe respektimin e legjislacionit tatimor nga subjektet, anëtarë të shoqatës kërkuese.

37. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka cenim të nenit 11 të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend për analizë të mëtejshme të kriterëve të kufizimit, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

*B. Për pretendimet për cenim të nenit 118 dhe 155 të Kushtetutës*

38. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se kufizimi i lirisë ekonomike, është bërë në kushtet e mungesës së delegimit ligjor, duke mos u respektuar kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës. VKM-ja nr.498, duke përcaktuar një subjekt të vetëm si autoritet të shënjitimit, nuk ka respektuar procedurat e përcaktuara nga ligji për akcizat, i cili nuk kishte autorizuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e një subjekti të vetëm koncesionar. Po sipas kërkueses, në vështrim të nenit 155 të Kushtetutës, tarifa kombëtare e shërbimit të shënjitimit (*pika 1.3 e vendimit*) si detyrim financiar kombëtar duhej realizuar me ligj të Kuvendit, dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave.

39. Gjykata ka çmuar se kuptimi mbi legjitimitimin e shoqatave duhet parë edhe në këndvështrimin e dallimit që ekziston ndërmjet pretendimit për cenim të një të drejte substanciale kushtetuese që ka lidhje me interesat e tyre dhe pretendimeve për antikushtetutshmëri të aktit nënligjor të kundërshtuar, në kuptim të rregullimeve kushtetuese procedurale, për të cilat mund t'i drejtohen Gjykatës subjektet e kushtëzuara sipas nenit 134 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 25.7.2008; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 17, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Prandaj, Gjykata vlerëson se përderisa VKM-ja nr. 498 nuk cenon lirinë ekonomike, nuk mund të vijojë më tej me analizën e vlerësimit të pretendimeve për cenimin e kërkesave të neneve 118 dhe 155 të Kushtetutës. Gjykata vëren se këto pretendime do të



merreshin në konsideratë vetëm në plotësim të kushtit të kërkuar nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, pra vetëm nëse do të rezultonte se kërkuësja kishte një interes real të cenuar nga VKM-ja e kundërshtuar. Nga analiza e mësipërme, rezultoi se e drejta e lirisë së veprimtarisë ekonomike nuk cenohet nga akti, objekt shqyrtimi, dhe, për pasojë, kërkuësja nuk legjitimohet për të iniciuar një proces kontrolli kushtetutshmërie, në lidhje me nenet 118 dhe 155 të Kushtetutës.

41. Si përfundim, Gjykata konkludon se VKM-ja nr. 200 është jashtë juridiksionit kushtetues, ndërsa VKM-ja nr. 498 nuk bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 të Kushtetutës, prandaj dhe kërkesa, objekt shqyrtimi, duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “c”, 132 dhe 134, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 49 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

Anëtarë kundër: Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar pjesërisht kundër: Sokol Berberi

#### MENDIM PAKICE

Jam dakord me shumicën për konkluzionin e arritur mbi VKM-në nr. 200, sipas të cilit ky akt është akt i karakterit individual dhe për rrjedhojë bie jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese në ushtrimin e kontrollit abstrakt, sipas nenit 131/c të Kushtetutës.

Ndërsa, për sa i përket VKM-së nr. 498 nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, prandaj dhe e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka arritur në konkluzionin se subjekti koncesionar (Koncesionari) është ngarkuar nga ana e shtetit me kryerjen e një shërbimi të një interesi të përgjithshëm, që konsiston në kryerjen e shënjimit në produktet e naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës dhe monitorimin e këtij procesi, mbi tarifa uniforme dhe kushte cilësie të njëjta. Ky proces është i lidhur për nga natyra, qëllimi dhe rregullat e përcaktuara mbi finalizimin e këtij procesi

me ushtrimin e pushtetit publik me qëllim shmangien e evazionit fiskal, funksion tipik i autoriteteve shtetërore. Duke qenë shërbime specifike, që lidhen me realizimin e një interesi të përgjithshëm, shumica ka vlerësuar se përjashtimi i tyre nga rregullat e konkurrencës nuk përbën cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike (*prg. 35 i vendimit*).

Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në rastin konkret VKM-ja nr. 498 ka cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkuësës, të sanksionuar nga neni 11 i Kushtetutës, dhe se ky cenim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e neneve 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës, për arsyet që përmbledhen në vijim.

#### - Në lidhje me pretendimin për cenimin e lirisë ekonomike

Kërkuësja ka pretenduar cenim të lirisë ekonomike në disa komponentë të rëndësishëm, si zhvillimi apo ushtrimi i iniciativës së lirë ekonomike, pasi treguesit e hidrokarbureve mund ta siguronin vetë shërbimin e markimit të kontrolluar/monitoruar më pas nga strukturat kompetente shtetërore. Po kështu, sipas saj, monopolizimi i këtij shërbimi, vetëm tek një subjekt, cenon konkurrencën dhe lirinë e tregtisë.

Për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, shumica, pasi ka ripohuar standardet e përcaktuara nga Gjykata, në lidhje me lirinë ekonomike, i është referuar jurisprudencës së GJED-së për zbatimin e rregullave të konkurrencës, në respektim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Sipas shumicës, ashtu sikundër vepron dhe GJED-ja, duhet bërë dallimi mes faktit nëse shteti mund të veprojë duke ushtruar autoritet publik, apo duke ndërmarrë kryerjen e aktiviteteve ekonomike, të natyrës tregtare, industriale, për të prodhuar dhe ofruar mallra e shërbime në treg. Me qëllim që të arrihet të bëhet ky dallim, është e nevojshme që në çdo çështje të vlerësohet veprimtaria e ushtruar nga shteti dhe të përcaktohet se cilës kategorie këto aktivitete i përkasin (*prg.31 dhe 32 të vendimit*).

Neni 11 i Kushtetutës, kërkon që sistemi ekonomik të bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Këto kritere kushtetuese që përcakton neni 11/3 duhen respektuar në çdo rast të kufizimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Çmoj se, në çështjen në shqyrtim, shumica fillimisht duhej të vlerësonte nëse shërbimi i shënjimit dhe monitorimit të hidrokarbureve është apo jo një aktivitet i natyrës ekonomike dhe, në vijim, nëse VKM-ja nr. 498 cenon apo jo lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Sipas VKM-së nr. 498, procesi i markimit dhe monitorimit do të realizohet përkundrejt një tarife shërbimi, të konsideruar tarifa kombëtare e shërbimit të

shënjimit, që do t'i paguhet koncesionarit nga subjektet e detyruara dhe do të jetë në shumën prej 614 (gjashtëqind e katërbëdhjetë) lekë plus TVSH-në, për 1000 (një mijë) litra të markuara (pika 1.3 e vendimit). Po sipas vendimit, "Shërbimi i shënjimit" përbëhet nga dy faza: i) "Shërbimi i shënjimit", që do të thotë procesi me anë të të cilit në produktet e shënjimit injektohet shënjuesi nga koncesionari; dhe ii) "Shërbimi i monitorimit", që do të thotë procesi me anë të të cilit koncesionari monitoron me anë të teknologjisë së posaçme në dispozicion të tij nëse produktet e shënjimit i janë nënshtruar shërbimit të shënjimit (pika 1.11 e vendimit).

Në vlerësimin tim, nisur nga standardet e mësipërme, markimi është një shërbim i natyrës ekonomike që ofrohet kundrejt pagesës. Rrjedhimisht, ky shërbim, duke pasur karakter ekonomik, si rregull duhet t'u nënshtrohet parimeve të ekonomisë së tregut, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe rregullave të konkurrencës.

Aspekti i dytë që duhet analizuar është nëse VKM-ja nr. 498 cenon apo jo lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses. Kjo VKM detyron për pajisjen me shërbimin e shënjimit, të gjitha subjektet të cilat tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonë, prodhojnë, rafinojnë, ose kryejnë çdo aktivitet tregtar me produktet, që janë të detyruara të paguajnë detyrimet fiskale për produktet e shënjimit dhe që kërkojnë kryerjen e shërbimit të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës të zotëruara prej tyre, sipas kuadrit ligjor për shërbimin e shënjimit (pika 1.10 e vendimit). Në rastin konkret, rezulton se procesi i shënjimit dhe monitorimit të karburanteve, sipas kontratës së koncesionit, do të realizohet nga Koncesionari. Sipas kësaj kontrate, shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve do të kryhet, në mënyrë ekskluzive, nga Koncesionari, për një periudhë 10-vjeçare.

Përderisa ky lloj shërbimi i është dhënë me koncesion një subjekti me të drejta ekskluzive, vlerësoj se kjo përbën një kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të kërkueses për të blerë shërbimin tek operatorë të tjerë në tregun e markimit dhe monitorimit të karburanteve. Duke përcaktuar Koncesionarin, si operator të vetëm, VKM-ja nr. 498 krijon një pozicion dominant në treg dhe cenon lirinë ekonomike të anëtarëve të kërkueses, pasi nuk i lejon të zgjedhin operatorin ku do të kryejnë procesin e detyruar të shënjimit. Ekskluziviteti që i është dhënë Koncesionarit nuk lejon hapësira alternative për ofrimin e shërbimit, duke krijuar një situatë monopoli në këtë sektor. Edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, si institucion i specializuar i kësaj fushe, në parashtrimet me shkrim të paraqitura para Gjykatës, u nënvizua se ky organ i ka

kërkuar Ministrisë së Financave, informacion për vlerësimin *ex ante* të koncesionit të markimit, detyrim të cilin kjo ministri nuk e kishte plotësuar (parashtrimet e datës 3.7.2013 të Autoritetit të Konkurrencës).

Për sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret, shërbimi i shënjimit dhe i monitorimit të hidrokarbureve është një shërbim i natyrës ekonomike dhe VKM-ja nr. 498 cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses. Në vijim, vlerësohet nëse ky cenim i lirisë ekonomike ka respektuar kushtet/kriteret kushtetuese.

**- Në lidhje me pretendimin për cenimin e rezervës ligjore në kuptim të neneve 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës**

Kërkuesja ka pretenduar se në rastin në shqyrtim kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike nuk është bërë me ligj, por me akt nënligjor, në shkelje të rezervës ligjore të parashikuar nga nenet 11 dhe 118 të Kushtetutës.

Shumica ka konkluduar se përderisa VKM-ja nr. 498 nuk cenon lirinë ekonomike, nuk mund të analizojë pretendimet që lidhen me cenimin e rezervës ligjore (prg. 40 i vendimit).

Në ndryshim nga shumica, siç jam shprehur edhe më sipër, vlerësoj se në rastin konkret kemi një kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të kërkueses dhe, në këto kushte, duhet vlerësuar nëse ky kufizim është bërë në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta. Në vështrim të neneve 11 dhe 17 të Kushtetutës "*kufizime të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve (neni 17/1). Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike*" (neni 11/3).

Parashikimi kushtetues i rregullimit me ligj, ka një funksion garantues të interesit publik të përgjithshëm, për arsye se garanton që, në fusha të caktuara, veçanërisht delikate, si në rastin e të drejtave themelore kushtetuese, vendimet të merren nga Kuvendi, si organi më përfaqësues i pushtetit sovran. Nëpërmjet një mekanizmi demokratik, siç është rezerva ligjore, garantohet parimi i ligjshmërisë, duke qenë se ligji i miratuar nga Kuvendi konsiderohet si burimi më i përshtatshëm që respekton të drejtat individuale dhe kënaq të ashtuquajturën *ratio* garantuese të rezervës ligjore. Në rastin e *rezervës ligjore relative* çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore, përveçse kur ligji ka parashikuar vetë çështjet kryesore, si dhe parimet mbi të cilat do të nxirren këto akte. Ndërsa, në rastin e *rezervës ligjore absolute* është norma kushtetuese që ia rezervon ligjit, në kuptimin formal, dhe vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete. Përdorimi i fjalës "vetëm" që përmendin nenet 11/3 e 17/1 të Kushtetutës nuk është rastësor, por

me qëllimin për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja “vetëm me ligj” referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 28, datë 27.5.2010, dhe nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen objekt shqyrtimi, kufizimi i lirisë ekonomike nuk është realizuar me ligj, por me akt nënligjor duke mos respektuar kriterin e vendosjes së kufizimit “vetëm me ligj”. Siç ka theksuar edhe Gjykata në jurisprudencën saj, shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, vlerësimi për të është diskrecion vetëm i Kuvendit dhe jo i organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave (*shih vendimet nr. 28, datë 27.5.2010, dhe nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 54/4 i ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat” (“ligji për akcizat”), me ndryshime, që ka shërbyer si bazë ligjore për nxjerrjen e VKM-së nr. 498, përcakton se: *“Procedurat specifike për importimin, hedhjen për konsum, lëvizjen, kontrollin, mbikëqyrjen, ngjyrujesit dhe shënjesit etj. për këto nënprodukte, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji. Kjo dispozitë autorizon Këshillin e Ministrave për rregullimin e procedurave specifike mbi importin dhe hedhjen për konsum të ngjyrujesit dhe shënjesit për nënproduktet e naftës”. Sipas po këtij ligji: “Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës janë kryer përpara importimit, importuesi duhet të paraqesë një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit nisës, në lidhje me llojin dhe sasinë e ngjyrujesit dhe/ose shënjesit të përdorur. Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi nuk është kryer përpara importimit, ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës mund të kryhet vetëm në magazina fiskale nga depozituesi i miratuar, në autorizimin për magazinë të të cilëve përfshihet edhe ngjyrosja dhe/ose shënjimi. Këto magazina duhet të jenë të pajisura me instrumente për dozimin dhe përzierjen ose instrumente të ngjashme që mund të sigurojnë ngjyrosjen dhe/ose shënjimin e rregullt (neni 55 i ligjit).*

Nga sa më sipër, është e qartë se ligji për akcizat ka autorizuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e procedurave mbi mbikëqyrjen, ngjyrujesit dhe shënjesit për nënproduktet e naftës, (çështja lëndore) si dhe parimet mbi të cilat do të nxirren aktet që do të rregullojnë procedurën e ngjyritimit për nënproduktet e naftës. Nga interpretimi literal i nenit 55 të ligjit për akcizat, konstatohet lejimi i markimit të hidrokarbureve në tregun e lirë, nga subjektet që mund ta kryejnë këtë proces, pasi të kenë plotësuar kriteret ligjore. Këtë lejim e përforcon edhe VKM-ja nr. 612, datë 5.9.2012 “Për

dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, sipas së cilës shënjimi dhe ngjyrimi do të bëhet nga vetë subjektet tregtare, të cilat do të pajisen me autorizimin përkatës dhe do të konsiderohen “depozitues të miratuar” (*nenet 103-107*). Pra, ligji për akcizat dhe VKM-ja nr. 612, *supra*, në harmoni me ligjin, përcaktojnë të gjitha parimet që udhëheqin procedurën e shënjimit dhe ngjyrosjes së karburanteve, proces i cili kryhet nga depozituesit e miratuar, sipas kriterëve përkatës ligjore. Ndryshe nga ky kuadër ligjor, VKM-ja nr. 498, objekt shqyrtimi, përbën një rregullim të ri, duke i dhënë Koncesionarit të drejta ekskluzive, në nivel kombëtar, për të kryer shërbimin e markimit dhe monitorimit të hidrokarbureve. Ky kufizim i lirisë së veprimtarisë ekonomike të kërkueses, që krijon një situatë monopoli në tregun e shërbimeve në fushën e hidrokarbureve, është bërë me një akt nënligjor, në kundërshtim me parimin e rezervës ligjore absolute, të parashikuar në nenet 11/3 dhe 17/1 të Kushtetutës.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, vlerësoj se, në rastin konkret, është cenuar parimi i rezervës ligjore absolute dhe, për rrjedhojë, kjo ka passjellë edhe cenimin e nenit 118 të Kushtetutës.

Si përfundim, për sa më sipër, çmoj se VKM-ja nr. 498 ka kufizuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses. Ky kufizim nuk është bërë me ligj, duke cenuar rezervën ligjore absolute, sipas neneve 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës. Në këto kushte, vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja duhej pranuar si e bazuar.

Anëtar: Sokol Berberi

#### MENDIM PAKICE

Ndryshe nga shumica, sipas së cilës “Subjekti koncesionar (Koncesionari) është ngarkuar nga ana e shtetit me kryerjen e një shërbimi të një interesi të përgjithshëm, që konsiston në kryerjen e shënjimit në produktet e naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës dhe monitorimin e këtij procesi, mbi tarifa uniforme dhe kushte cilësie të njëjta Ky proces është i lidhur për nga natyra, qëllimi dhe rregullat e përcaktuara mbi finalizimin e këtij procesi me ushtrimin e pushtetit publik me qëllim shmangien e evazionit fiskal, funksion tipik i autoriteteve shtetërore. Duke qenë shërbime specifike, që lidhen me realizimin e një interesi të përgjithshëm, shumica ka vlerësuar se përjashtimi i tyre nga rregullat e konkurrencës nuk përbën cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike” (prg. 35 i vendimit), ne gjyqtarët në pakicë çmojmë se VKM-ja nr. 200 datë 13.3.2013, dhe VKM-ja nr. 498, datë 30.5.2013, kanë cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses, të sanksionuar nga neni 11 i Kushtetutës, dhe se ky cenim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e neneve 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës.

### **1. Në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese**

Në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese pakica vlerëson se çështja bën pjesë në juridiksionin e kësaj gjykate, bazuar në përmbajtjen e dispozitës së nenit 131/c të Kushtetutës, sipas së cilës Gjykata Kushtetuese vendos për: c) *Pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.*

Siç rezultoi e provuar në gjykim, VKM-ja nr. 200, datë 13.3.2013, dhe VKM-ja nr. 498, datë 30.5.2013, janë nxjerrë nga një organ qendror, Këshilli i Ministrave, si dhe të dy këto akte kanë karakter normativ.

Kontrata e koncesionit, e miratuar me VKM-në nr. 200, datë 13.3.2013, nuk rregullon vetëm të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese, por përmban dhe rregulla me karakter të përgjithshëm që vendosin detyrime për një numër subjektsh të papërcaktuara individualisht.

Konkretisht, sipas nenit 1 të kontratës së koncesionit, miratuar me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013, të KM-së, përcaktohen detyrimet për të zbatuar kushtet e kësaj kontrate *“të gjitha subjektet që tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonjë, prodhojnë hidrokarbure ose kryejnë çdo aktivitet tjetër tregtar me produktet e shënjimit”*.

Ky karakter normativ i VKM-së nr. 200 përforcohet më shumë me daljen e VKM-së nr. 498, ku në pikën 1/10 janë përcaktuar subjektet e detyruara për zbatimin e vendimit dhe që përkufizohen në *“të gjitha subjektet që tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonjë, prodhojnë hidrokarbure ose kryejnë çdo aktivitet tjetër tregtar me produktet e shënjimit”*.

Karakterit normativ i këtyre dy akteve përcaktohet edhe nga fakti se me këto VKM, shërbimi i koncesionarit për shënjimin mbi produkt, kushtëzon edhe shlyerjen nga subjektet të detyrimeve të tjera fiskale të caktuara me ligj.

Një tjetër element që vërteton se të dy vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt gjykimi, kanë karakter normativ dhe jo individual, është referimi që ato bëjnë tek ligje të tjera të përgjithshme me karakter normativ që kanë efekt mbi gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke parashikuar sanksione për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e hidrokarbureve, dhe që nuk përmbushin detyrimet e përcaktuara nga koncesionari i ngarkuar me dy vendimet e Këshillit të Ministrave.

Që të dyja aktet kanë karakter normativ, del qartë edhe nga pika 6 e VKM-së nr. 498, sipas së cilës *“të gjitha institucionet publike të RSH, si dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të ndihmojnë, të japin akses në informacion dhe të bashkëpunojnë me koncesionarin dhe autoritetin sa herë që këta të fundit e kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e këtij vendimi”*.

Për shkaqet e mësipërme, pakica vlerëson se çështja hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131, pika “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### **2. Në lidhje me pretendimin për cenimin e lirisë ekonomike**

Ndryshe nga shumica, pakica vlerëson se në çështjen objekt shqyrtimi, shërbimi i shënjimit dhe monitorimit të hidrokarbureve është një shërbim i natyrës ekonomike, arsye për të cilën VKM-ja nr. 200 dhe VKM ja nr. 498 cenojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses.

Siç dhe argumentoi në gjykim kërkuesja, me anë të dy vendimeve objekt gjykimi, Këshilli i Ministrave i ka cenuar shoqatës lirinë ekonomike në disa komponentë të rëndësishëm, si zhvillimi apo ushtrimi i iniciativës së lirë ekonomike, pasi tregtuesit e hidrokarbureve mund ta siguronin vetë shërbimin e markimit, të kontrolluar/monitoruar më pas nga strukturat kompetente shtetërore. Po kështu, monopolizimi i këtij shërbimi, vetëm te një subjekt, cenon konkurrencën dhe lirinë e tregtisë.

Neni 11 i Kushtetutës kërkon që sistemi ekonomik të bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Këto kritere kushtetuese që përcakton neni 11/3 duhen respektuar në çdo rast të kufizimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Sipas Kontratës Koncesionare, miratuar me VKM-në nr. 200, dhe rregullave të vendosura me VKM-në nr. 498, procesi i markimit dhe monitorimit do të realizohet përkundrejt një tarife shërbimi, të konsideruar tarifa kombëtare e shërbimit të shënjimit, që do t'i paguhet koncesionarit nga subjektet e detyruara dhe do të jetë në shumën prej 614 (gjashtëqind e katërmëdhjetë) lekë, plus TVSH-në, për 1000 (një mijë) litra të markuara (*pika 1.3 e vendimit*). Po sipas vendimit, “Shërbimi i shënjimit” përbëhet nga dy faza: i) “Shërbimi i shënjimit”, që do të thotë procesi me anë të të cilit në produktet e shënjimit injektohet shënjuesi nga Koncesionari; dhe ii) “Shërbimi i monitorimit”, që do të thotë procesi me anë të të cilit Koncesionari monitoron me anë të teknologjisë së posaçme në dispozicion të tij nëse produktet e shënjimit i janë nënshtruar shërbimit të shënjimit (*pika 1.11 e vendimit*).

Pakica vlerëson se nisur nga standardet e mësipërme, markimi është një shërbim i natyrës ekonomike që ofrohet kundrejt pagesës. Rrjedhimisht, ky shërbim, duke pasur karakter ekonomik, si rregull duhet t'u nënshtrohet parimeve të ekonomisë së tregut, lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe rregullave të konkurrencës.

Në gjykim u provua se procesi i shënjimit dhe monitorimit të karburanteve, sipas kontratës së koncesionit, miratuar me VKM-në nr. 200, datë 13.3.2013, do të

realizohet nga Koncesionari. Sipas kësaj kontrate, shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve do të kryhet, në mënyrë ekskluzive, nga Koncesionari, për një periudhë 10-vjeçare.

Për atë kohë sa ky lloj shërbimi i është dhënë me koncesion një subjekti me të drejta ekskluzive, pakica çmon se kjo përbën një kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike të kërkueses për të blerë shërbimin tek operatorë të tjerë në tregun e markimit dhe monitorimit të karburanteve. Duke përcaktuar Koncesionarin, si operator të vetëm, VKM-të objekt gjykimi i japin atij një pozicion dominant në treg, duke cenuar lirinë ekonomike të anëtarëve të kërkuesit, pasi nuk i lejon të zgjedhin operatorin ku do të kryejnë procesin e detyruar të shënjimit. Ekskluziviteti që i është dhënë Koncesionarit nuk lejon hapësira alternative për ofrimin e shërbimit, duke krijuar një situatë monopoli në këtë sektor. Edhe nga Autoriteti i Konkurrencës, si institucion i specializuar i kësaj fushe, në parashtrimet me shkrim të paraqitura para Gjykatës, u nënvizua se ky organ i ka kërkuar Ministrisë së Financave informacion për vlerësimin *ex ante* të koncesionit të markimit, detyrim të cilin kjo ministri nuk e kishte plotësuar (*parashtrimet e datës 3.7.2013 të Autoritetit të Konkurrencës*).

### **3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e rezervës ligjore, në kuptim të neneve 11, 17 dhe 118 të Kushtetutës**

Pakica vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, kërkueses i është kufizuar liria ekonomike dhe ky kufizim nuk është realizuar me ligj, por me akt nënligjor, duke mos respektuar kriterin e vendosjes së kufizimit “vetëm me ligj”, në kundërshtim me parimin e rezervës ligjore absolute, të parashikuar në nenet 11/3 dhe 17/1 të Kushtetutës.

Siç ka theksuar edhe Gjykata në jurisprndencën saj, shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, vlerësimi për të është diskrecion vetëm i Kuvendit dhe jo i organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave (*shih vendimet nr. 28, datë 27.5.2010, dhe nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 54/4 i ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat” (“ligji për akcizat”), me ndryshime, që ka shërbyer si bazë ligjore për nxjerrjen e VKM-së nr. 498, përcakton se: “*Procedurat specifike për importimin, hedhjen për konsum, lëvizjen, kontrollin, mbikëqyrjen, ngjyruarit dhe shënjuesit etj. për këto nënprodukte, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji. Kjo dispozitë autorizon Këshillin e Ministrave për rregullimin e procedurave specifike mbi importin dhe hedhjen për konsum të ngjyruarit dhe shënjuesit për nënproduktet e naftës*”. Sipas po këtij ligji: “Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës janë kryer përpara importimit, importuesi duhet të paraqesë një

*certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit nisës, në lidhje me llojin dhe sasinë e ngjyruarit dhe/ose shënjuesit të përdorur. Kur ngjyrosja dhe/ose shënjimi nuk është kryer përpara importimit, ngjyrosja dhe/ose shënjimi i vajrave të naftës mund të kryhet vetëm në magazina fiskale nga depozituesi i miratuar, në autorizimin për magazinë të të cilëve përfshihet edhe ngjyrosja dhe/ose shënjimi. Këto magazina duhet të jenë të pajisura me instrumente për dozimin dhe përzjerjen ose instrumente të ngjashme që mund të sigurojnë ngjyrosjen dhe/ose shënjimin e rregullt (neni 55 i ligjit).*

Nga sa më sipër, është e qartë se ligji për akcizat ka autorizuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e procedurave mbi mbikëqyrjen, ngjyruarit dhe shënjuesit për nënproduktet e naftës (*çështja lëndore*) si dhe parimet mbi të cilat do të nxirren aktet që do të rregullojnë procedurën e ngjyruarit për nënproduktet e naftës. Nga interpretimi literal i nenit 55, të ligjit për akcizat, konstatohet lejimi i markimit të hidrokarbureve në tregun e lirë, nga subjektet që mund ta kryejnë këtë proces, pasi të kenë plotësuar kriteret ligjore. Këtë lejim e përforcon edhe VKM-ja nr. 612, datë 5.9.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, sipas së cilës, shënjimi dhe ngjyrimi do të bëhet nga vetë subjektet tregtare, të cilat do të pajisen me autorizimin përkatës dhe do të konsiderohen “depozitues të miratuar” (*nenet 103-107*). Pra, ligji për akcizat, dhe VKM-ja nr. 612, *supra*, në harmoni me ligjin, përcaktojnë të gjitha parimet që udhëheqin procedurën e shënjimit dhe ngjyrosjes së karburanteve, proces i cili kryhet nga depozituesit e miratuar, sipas kriterëve përkatës ligjore. Ndryshe nga ky kuadër ligjor, VKM-ja nr. 200 dhe specifikisht VKM-ja nr. 498, i kanë dhënë Koncesionarit të drejta ekskluzive, në nivel kombëtar, për të kryer shërbimin e markimit dhe monitorimit të hidrokarbureve. Ky kufizim i lirisë së veprimtarisë ekonomike të kërkueses, që krijon një situatë monopoli në tregun e shërbimeve në fushën e hidrokarbureve, është bërë me një akt nënligjor,

Parashikimi kushtetues i rregullimit me ligj, ka një funksion garantues të interesit publik të përgjithshëm, për arsye se garanton që, në fusha të caktuara, veçanërisht delikate, si në rastin e të drejtave themelore kushtetuese, vendimet të merren nga Kuvendi, si organi më përfaqësues i pushtetit sovran. Nëpërmjet një mekanizmi demokratik, siç është rezerva ligjore, garantohet parimi i ligjshmërisë, duke qenë se ligji i miratuar nga Kuvendi konsiderohet si burimi më i përshtatshëm që respekton të drejtat individuale dhe kënaq të ashtuquajturën *ratio* garantuese të rezervës ligjore. Në rastin e rezervës ligjore relative çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore, përveçse kur ligji ka parashikuar vetë çështjet kryesore, si dhe parimet mbi të cilat do të nxirren këto akte.

Ndërsa, në rastin e *rezervës ligjore absolute* është norma kushtetuese që ia rezervon ligjit, në kuptimin formal, dhe vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete. Përdorimi i fjalës “vetëm” që përmendin nenet 11/3 e 17/1 të Kushtetutës nuk është rastësor, por me qëllimin për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se shprehja “vetëm me ligj” referon në kompetencën e organit ligjvënës, dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimet nr. 28, datë 27.5.2010, dhe nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Si përfundim, për sa më sipër, pakica çmon se VKM-ja nr. 200, datë 13.3.2013, dhe VKM-ja nr. 498, datë 30.5.2013, kanë kufizuar pa ligj lirinë e veprimtarisë ekonomike të kërkueses, arsye për të cilën kërkesa duhet të ishte pranuar, duke shpallur si të papajtueshme me Kushtetutën të dy vendimet e mësipërme të Këshillit të Ministrave.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

**VENDIM**  
**Nr. 18, datë 31.3.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 26.11.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 48/20 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Ndoc Molla

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosarsyetimit të vendimit penal të Gjykatës së Lartë, brenda një afati të arsyeshëm.

Shfuqizimi i vendimit të datës 16.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dëmshpërblimi në shumën 200 000 lekë nga ana e Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 42, 131/f, 134, pika 1/g, 134/2 dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Me vendimin nr. 260, datë 19.6.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të të pandehurit Ndoc Shtjefën Molla, për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve” (e kryer në formën e përdorimit), vepër kjo e parashikuar si krim nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (muaj) burgim e 200 000 (dyqind mijë) lekë gjobë. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim dhënë me këtë vendim, ndaj të pandehurit Ndoc Shtjefën Molla, duke u vënë i pandehuri në provë, me kusht që gjatë kohës së provës që është dy vjet dhe fillon nga dita e sotme, datë 19.6.2009, të mos kryejë vepër tjetër penale.....” Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.*

2. Me vendimin nr. 16, datë 25.1.2010, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 260, datë 19.6.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Ndoc Molla (parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal), pasi nuk vërtetohet fajësia e tij”.*

3. Mbi rekursin e paraqitur nga prokurori, me vendimin e datës 16.1.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur “*Prishjen e vendimit nr. 16, datë 25.1.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 260, datë 19.6.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me fajësinë dhe dënimin e tij me burgim. Ndryshimin e këtij vendimi duke hequr dënimin me gjobë.”*

4. Edhe pse vendimi i Gjykatës së Lartë (pjesa urdhëruese) është shpallur në datën 16.1.2013, kërkuesi nuk është pajisur me një kopje të tij, duke mos u njohur me argumentet e vendimit të asaj gjykate që ka vendosur dënimin e tij. Kërkuesi rezultoi t’i jetë drejtuar disa herë Gjykatës së Lartë me kërkesë për vënien në dispozicion të vendimit të arsyetuar (kërkesat e datës 11.3.2013 dhe 3.7.2013). Me shkresën nr. 41/1 prot., datë 10.7.2013, kancelari i Gjykatës së Lartë i është përgjigjur kërkuesit duke e informuar vetëm lidhur me dispozitivin e vendimit të Kolegjit Penal.

5. Me kërkesën e datës 9.9.2013, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit brenda një afati të arsyeshëm.

6. Pas marrjes së vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese i ka kërkuar Gjykatës së Lartë informacion zyrtar për fazën në të cilën ndodhej arsyetimi i këtij vendimi. Me shkresën e datës 5.11.2013, Gjykata e Lartë ka dërguar

një kopje të arsyetuar të vendimit, i cili mban datën e shpalljes së tij, por nuk ka informuar lidhur me momentin në të cilin ai është depozituar i arsyetuar në sekretarinë e asaj gjykate dhe është bërë i disponueshëm nga kërkuesi.

## II

7. *Kërkuesi Ndoc Molla*, pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, si dhe kërkon edhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në thelb këto shkaqe:

7.1 Neni 142 i Kushtetutës ka sanksionuar detyrimin e gjykatave që të arsyetojnë vendimet e tyre dhe ligji organik i Gjykatës së Lartë ka parashikuar një afat 30 ditor për arsyetimin e vendimeve. Gjykata e Lartë jo vetëm që nuk ka zbatuar ligjin e saj organik, por edhe me kërkesat e përsëritura të kërkuesit dhe avokates së tij ka vepruar me keqdashje për të penguar kërkuesin për të ushtruar ankimin e tij më tej. Nga ana e Gjykatës së Lartë kërkuesi është informuar vetëm për dispozitivin e vendimit, por nuk i është vënë në dispozicion një kopje e vendimit. Në këtë mënyrë ai ka humbur afatin 6-mujor për t'iu drejtuar Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), me një kërkesë të plotë që përfshinte më shumë se cenimin e nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

7.2 Neni 6 i KEDNJ-së përfshin si element të procesit të rregullt edhe detyrimin që gjykata duhet të japë një arsyetim të detajuar. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së është theksuar se gjykatat kombëtare duhet t'i japin përgjigje argumenteve të ngritura nga palët dhe se ka shkelje të këtij neni nëse nuk i kanë dhënë përgjigje një argumenti thelbësor në çështjen në shqyrtim. Në rastin konkret, kur Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar fare vendimin e saj, GJEDNJ-ja potencialisht do të konstatonte unanimisht shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

7.3 Neni 6/1 i KEDNJ-së nuk parashikon shprehimisht që një vendim i arsyetuar duhet të jepet në formë të shkruar apo në një kohë të përcaktuar, por është e pranueshme që arsyetimi të jepet në një kohë të arsyeshme që të mos cenojë të drejtën për ankim të kërkuesit.

7.4 Duke qenë se konstatimi i cenimit nuk i zgjidh pasojat e një shtate të tillë, kërkuesi kërkon shfuqizimin e tij pasi, duke qenë se ai është shpallur i paarsyetuar dhe nuk është arsyetuar brenda afatit 30 ditor, ai është një vendim absolutisht i pavlefshëm.

7.5 Për shkak të shqetësimit që kjo çështje i ka dhënë kërkuesit, ai kërkon edhe dëmshpërblim nga ana e Gjykatës së Lartë, për moskryerje të rregullt të detyrës prej asaj gjykate.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Lidhur me pretendimin për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm*

8. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) i vlerëson pretendimet e paraqitura para saj në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

9. Në jurisprudencën kushtetuese, e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është konsideruar pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke iu dhënë njëkohësisht mundësinë për ta kundërshtuar atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse (përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese) dhe, që kjo të bëhet e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit në të cilin gjykata tregon me qartësi faktet, ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 29, datë 15.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, edhe pse neni 142 i Kushtetutës i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Neni 43 i Kushtetutës ka sanksionuar të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Gjykata ka theksuar se e drejta themelore e ankimit është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se "...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit" ose, "...nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë". E drejta e ankimit, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetuta, në nenin 43, parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit

kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 14, datë 5.7.2005; nr. 5, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 19, datë 23.12.2004; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka vlerësuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kondicionohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se neni 19 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se: “*Vendimet e Gjykatës së Lartë shpallen të arsyetuara jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, së bashku me mendimet e pakicës, botohen në Buletinin Periodik të Gjykatës së Lartë. Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.*” Nga materialet e çështjes konkrete në shqyrtim, rezulton se kërkuesi është njohur me vendimin penal të Gjykatës së Lartë (pjesën urdhëruese të tij) në datën 16.1.2013, kur është zhvilluar edhe seanca gjyqësore, por vendimi i

arsyetuar mbi shkaqet për prishjen e vendimit nr. 16, datë 25.1.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, që kishte pushuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit, dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 260, datë 19.6.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që e kishte deklaruar atë fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve” (e kryer në formën e përdorimit), është vënë në dispozicion të palëve disa muaj më vonë, pas fillimit të shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese.

13. Gjykata ka vlerësuar edhe se, jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka parashikuar një afat dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës përpara Gjykatës Kushtetuese, për pretendimet që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 dhe 131/f të Kushtetutës, nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte Gjykata vlerëson se, edhe pse Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin ligjor të parashikuar në ligjin e saj organik për shpalljen të arsyetuar të vendimit gjyqësor të asaj gjykate, kërkuesi nuk ka humbur afatin ligjor për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së atij vendimi, në lidhje me të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Në këto kushte, e drejta e kërkuesit për të pasur një gjykim përfundimtar lidhur me pretendimet e tij, është e garantuar.

*B. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura në kërkesë*

14. Gjykata vëren se në objekt të kërkesës, kërkuesi ka kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të datës 16.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, por ai nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur këtë kërkim, kjo edhe për arsye se kërkuesi nuk ishte njohur ende me argumentet e vendimit të Kolegjit Penal.

15. Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Kërkuesi, në objekt të kërkesës së tij, ka kërkuar edhe dëmshpërblim nga ana e Gjykatës së Lartë, në shumën 200 000 lekë. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se ai është një kërkim i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar. Në këto kushte, edhe kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vitore Tusha

#### MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

Në arsyetimin e saj shumica ka theksuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Në këtë kuptim, edhe pse Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin ligjor të parashikuar në ligjin e saj organik për shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor të asaj gjykate, kërkuesi nuk ka humbur afatin ligjor për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së atij vendimi, në lidhje me të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, sipas shumicës, e drejta e kërkuetit për të pasur një gjykim përfundimtar lidhur me pretendimet e tij është e garantuar (prg. 13 i vendimit).

E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë

atë. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë. Gjykatat duhet të parashtrajnë, në mënyrë të përmbledhur, rrethanat e faktit, provat mbi të cilat bazohet vendimi, mënyrën e vlerësimit të këtyre provave, pra të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimet e tyre. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

GJEDNJ-ja, në çështjen *Delcourt kundër Belgjikës*, ndër të tjera, është shprehur se “vendimet gjyqësore gjithmonë ndikojnë mbi personat. Megjithatë vendimi i Gjykatës së Kasacionit thjesht konfirmon ose anulon një vendim, ai vendim mund të ketë efekte të ndryshme në pozicionin e personit të interesuar. Madje, nganjëherë, gjykimi i Kasacionit ka pasoja shumë më të mëdha mbi fatin e një personi se vendimet e gjykatës së faktit dhe të apelit. Në një shoqëri demokratike, në kuptimin e kësaj Konvente, e drejta për një administrim të mirë të drejtësisë zë një vend kaq të dallueshëm, sa që asnjë interpretim i ngushtë i nenit 6 § 1 nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e kësaj dispozite” (*shih çështjen Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.1.1970, § 25, 26*).

Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrimin për të dhënë arsyet e vendimmarrjes së saj brenda një afati të arsyeshëm. Kur është shpallur vendimi, ai është njohur vetëm me përmbajtjen e pjesës urdhëruese të tij pa iu vënë në dispozicion kopja e arsyetuar e vendimit dhe deri në datën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk ka mundur të njihet me shkaqet që e kanë çuar Gjykatën e Lartë në mbajtjen e qëndrimit të saj (*shih prg. 4 të vendimit*).

Gjykata ka vlerësuar se në juridiksionin e saj përfshihen edhe kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, arsyeshmëria e zgjatjes së procesit vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, pra nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuetit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuetin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore, numrin e personave të pandehur etj. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se kërkuesi është gjykuar për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve” (e kryer në formën e përdorimit), parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Duke i referuar vendimeve gjyqësore dhe rrethanave faktike nuk rezultojnë që kjo çështje të ketë qenë komplekse, në kuptim të elementeve të sipërcituara, çka do të mund të justifikonte vonesat në arsyetimin e vendimit lidhur me të.

Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, nuk rezultojnë që ai të ketë sjellë vonesa, por përkundrazi i është drejtuar disa herë Gjykatës së Lartë duke i kërkuar vënien në dispozicion të vendimit të arsyetuar të dhënë ndaj tij (kërkesat e datës 11.3.2013 dhe 3.7.2013).

Në lidhje me sjelljen e autoriteteve publike, Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit, në mënyrë të tillë, që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë, që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitohen çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësi të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkak që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 32, datë 22.7.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Neni 19 i ligjit organik të Gjykatës së Lartë ka parashikuar një afat 30 ditor nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor për shpalljen të arsyetuara të vendimeve të asaj gjykate. Nga rrethanat e çështjes rezultojnë se Gjykata e Lartë e ka shpallur pjesën urdhëruese të vendimit të saj në datën 16.1.2013, kur është zhvilluar edhe seanca gjyqësore, kurse argumentet për qëndrimin e saj për shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë, i janë vënë në dispozicion kërkuesit pas më shumë se 6 muaj (nëse i referohemi shkresës së kancelarit të Gjykatës së Lartë) dhe më shumë se 8 muaj (nëse i referohemi momentit kur vendimi i arsyetuar është bërë i aksesueshëm në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë).

Sipas shumicës, edhe pse Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin ligjor të parashikuar në ligjin e saj organik për shpalljen e arsyetuar të vendimit gjyqësor të asaj gjykate, fakti që kërkuesi nuk e ka humbur afatin ligjor për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së atij vendimi, nuk e bën procesin ligjor të parregullt.

Nuk jemi dakord me këtë qëndrim të shumicës. Gjykata, bazuar dhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se vetëm fakti që autoritetet shtetërore kanë zbatuar vendimin, pas një vonese thelbësore, nuk mund të konsiderohet se i heq automatikisht kërkuesit statusin e personit të cilit i është cenuar një e drejtë, në kuptimin kushtetues dhe se, rrjedhimisht, kërkuesi mundet ende të pretendojë se është i cenuar në të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Për më tepër, vlerësimi i respektimit të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, bëhet nga Gjykata rast pas rasti dhe në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Në rastin në shqyrtim rezultojnë se kërkuesi është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 6 vjet burgim (dënim i cili është pezulluar) dhe 200 000 lekë gjobë, vendim i cili është prishur nga gjykata e apelit, duke u vendosur pushimi i çështjes penale pasi nuk provohet fajësia e kërkuesit. E vënë në lëvizje në bazë të rekursit të paraqitur nga prokurori, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të pafajësisë dhe lënien në fuqi të vendimit të apelit lidhur me fajësinë dhe dënimin e tij me burgim, duke hequr dënimin me gjobë.

Në këto kushte, duke pasur parasysh efektet dhe ndikimin që vendimi i Gjykatës së Lartë do të sjellë mbi kërkuesin, i cili humb tashmë statusin e një personi të pafajshëm, për të ishte shumë e rëndësishme që të njihej sa më parë me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë. Njohja me vendimin e arsyetuar do t'i krijonte mundësinë kërkuesit të vlerësonte dhe të përdorte, brenda një kohe të arsyeshme, mjetet juridike për të kundërshtuar argumentet e përdorura nga Gjykata e Lartë, në funksion të garantimit substancial të së drejtës së ankimit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vitore Tusha

**VENDIM**  
**Nr. 19, datë 2.4.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 18.2.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 55/27 Akti, që i përket:

KËRKUES: Brianko Beqiraj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve: nr. 1126, datë 30.7.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 190, datë 3.3.2010 i Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-321, datë 20.3.2012, dhe nr. 00-2012-674, datë 17.5.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që kërkonte pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkonte rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1126, datë 30.7.2009, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “vjedhje me dhunë”, ndaj disa shtetasve, dhe e ka dënuar me 10 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 190, datë 3.3.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1126, datë 30.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Kërkuari i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2012-321, datë 20.3.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit.

4. Sërish kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim të vendimit penal të formës së prerë. Me vendimin nr. 00-2012-674 të datës

17.5.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit penal të formës së prerë.

5. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

5.1 Prokuroria e ka akuzuar pa prova, pa u mbështetur në ligj, ka tjetërsuar provat shkresore, me të padrejtë ka zgjatur afatin e hetimeve, ndërsa gjykata nuk është shprehur në lidhje me kërkesat e paraqitura prej tij gjatë gjykimit, në lidhje me provat;

5.2 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë dhe jo të vendoste mospranimin në dhomë këshillimi. Ky Kolegj, në kundërshtim me ligjin, nuk ka marrë parasysh provat e reja për të rishikuar vendimin penal të formës së prerë;

5.3 I njëjti trup gjykues në Gjykatën e Lartë ka gjykuar dy herë në lidhje me kërkuarin dhe i njëjti gjyqtar ka marrë pjesë në tri gjykime ndaj kërkuarit, për të njëjtën çështje.

6. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, në parashtrimet drejtuar Gjykatës, ka paraqitur këto prapësime:

6.1 Pretendimet e kërkuarit, si ato që kanë të bëjnë me fazën e hetimeve paraprake, ashtu dhe me proceset gjyqësore të zhvilluara në tri nivelet e gjykimit, janë haptazi të pabazuara; hetimet paraprake janë bërë konform ligjit procedural penal dhe gjykatat i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, duke respektuar standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor;

6.2 Pjesëmarrja e katër gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy gjykime ndaj kërkuarit nuk përbën papajtueshmëri të tyre sipas nenit 15 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe as shkak për heqjen dorë nga gjykimi, në bazë të nenit 17 të KPP-së;

6.3 Pretendimet e kërkuarit për proces të parregullt ligjor në shqyrtimin e rekursit dhe kërkesës për rishikim në Gjykatën e Lartë, nuk janë të bazuara.

**II**

**Vlerësimi i Gjykatës**

*A. Për pretendimet në lidhje me marrjen e provave gjatë gjykimit*

7. Kërkuari ka pretenduar se Prokuroria e ka akuzuar pa prova, pa u mbështetur në ligj, ka tjetërsuar provat shkresore, me të padrejtë ka zgjatur afatin e hetimeve, ndërsa gjykata nuk është shprehur në lidhje me kërkesat e paraqitura prej tij gjatë gjykimit, në lidhje me provat.

8. Nisur nga natyra e këtyre pretendimeve të paraqitura nga kërkuari, Gjykata rithekson se, mbi bazën e jurisprudencës së saj të konsoliduar, mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është, si rregull, atribut i gjykatave të

zakonshme, pra bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material, apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme (shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 23, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 31, datë 5.7.2011, dhe nr. 22, datë 22.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (shih vendimet nr. 47, datë 7.11.2011 dhe nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se “neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt, por nuk përcakton rregullat për pranimin e provave si të tilla, çështje e cila i përket kryesisht rregullimit sipas legjislacionit të brendshëm” (shih *Schenk kundër Zvicrës*, 12 korrik 1988, § 45). Gjykata, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, është shprehur se gjykatat kanë detyrim të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument apo pretendim të palëve (shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012, dhe nr. 35, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

9. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se, pretendimet e kërkuarit, në drejtim të vlerësimit të provave dhe disponimeve në lidhje me to të gjykatës, janë haptazi të pabazuara.

*B. Për detyrimin e Gjykatës së Lartë për të kaluar për shqyrtim në seancë plenare rekursin dhe kërkesën për rishikim*

10. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej t'i kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore si rekursin, ashtu edhe kërkesën për rishikim, dhe jo të vendoste mospranimin e tyre në dhomë këshillimi.

11. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se verifikimi, nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i dhomës së këshillimit dhe është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Vlerësimi dhe analiza nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit bëhet nga Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, e cila, në rast se krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë

në dosjen gjyqësore, ka në kompetencë të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (shih vendimet nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 45, datë 23.7.2012; nr. 4, datë 25.2.2009; nr. 5, datë 26.1.2007, dhe nr. 8, datë 2.5.2006, të Gjykatës Kushtetuese).

12. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës (shih vendimin nr. 18, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Nga përmbajtja e dispozitave procedurale penale për rishikimin (nenet 450 dhe 453 të KPP-së), rezulton se kërkesa për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Ky kolegji, në dhomën e këshillimit, verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkuarit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit si dhe praninë e kriterëve ligjore për shqyrtimin e saj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim.

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me vlerësimin paraprak që Gjykata e Lartë u bën çështjeve në dhomë këshillimi. Gjatë këtij procesi Kolegji i Gjykatës së Lartë shqyrton, në dhomë këshillimi, nëse shkaqet e ngritura në rekurs apo në kërkesën për rishikim janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi apo kërkesa për rishikim përmban apo jo shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore.

14. Për pasojë, duke pasur parasysh standardet e mësipërme të gjykimit në dhomë këshillimi, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit, në drejtim të detyrimit të Gjykatës së Lartë për të kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore rekursin dhe kërkesën për rishikim, janë haptazi të pambështetura.

*C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*

15. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Sipas tij, i njëjti gjyqtar ka qenë pjesë e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë në tri gjykime ndaj kërkuarit, për të njëjtën çështje, përkatësisht në lidhje me: masën e sigurimit (vendimi nr. 167, datë 12.9.2008), rekursin mbi themelin (vendimi nr. 00-2012-321, datë 20.3.2012) dhe kërkesën për rishikim (vendimi nr. 674, datë 17.5.2012). Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar se i njëjti trup gjykues në Gjykatën e Lartë ka gjykuar dy herë në lidhje me kërkuarin.

16. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë

anëtarëve të saj<sup>2</sup>, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për këtë pretendim, vendosi refuzimin.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

#### VENDOSI:

-Refuzimin e kërkesës për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

-Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Fatos Lulo

#### VENDIM

**Nr. 20, datë më 4.4.2014**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 17.9.2013 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 24/3 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Avokati i Popullit, përfaqësuar nga Arben Gjoleka dhe Alket Jaupi, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga avokati i shtetit Dardan Mustafaj.

<sup>2</sup> Votuan për pranimin gjyqtarët: B. Dedja, V. Kristo, S. Berberi dhe F. Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: V. Tusha, A. Xhoxhaj, B. Imeraj dhe F. Lulo.

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Dardan Mustafaj, me autorizim.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Eva Vaso, Geraldina Prodani, Saida Turabi dhe Isida Koka, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4/1, 7, 15, 17, 18/1, 42, 60/1, 116, 118, 131/a, 134/2, 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 49 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 24/c i ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

##### I

1. Në vitin 2011, Këshilli i Ministrave, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neni 589/4 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), neneve 43 dhe 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, ka miratuar udhëzimin nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit” (udhëzimi nr. 2/2011). Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit nga llogaria e thesarit, të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme<sup>3</sup> që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë. Sipas tij, ekzekutimi i vendimeve realizohet nga njësia shpenzuese<sup>4</sup> përgjegjëse me fondet buxhetore të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës për këtë qëllim, ose me të ardhura të tjera, të siguruara nga njësia e qeverisjes së përgjithshme (pika 3). Në rast se njësia shpenzuese nuk ka ekzekutuar në mënyrë vullnetare vendimin gjyqësor të formës së prerë, nisin procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, nga ana e

<sup>3</sup> Në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “qeverisje e përgjithshme” është tërësia e njëjësive të qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

<sup>4</sup> Sipas po këtij ligji, “njësi shpenzuese” është njësia më e vogël organizative e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, për të cilën janë detajuar fondet buxhetore.

përmbaresit gjyqësor, në llogarinë e tyre në degën e thesarit (pikat 5 dhe 6). Po ashtu, në pikën 7 të udhëzimit nr. 2/2011, parashikohet procedura që ndiqet në rast se përmbaresi gjyqësor kërkon vendosjen e masës së sekuestros, ku përfshihen: dokumentet që ky i fundit duhet t'i dërgojë titullarit të njësisë shpenzuese dhe degës së thesarit (shkronja "a"); procedurën që ndiqet nga titullari i njësisë shpenzuese dhe dega e thesarit (shkronjat "b" dhe "c"); vendosja e masës së sekuestros nga ana e degës së thesarit në shpenzimet operative të njësisë shpenzuese, artikulli buxhetor 602, pa u prekur shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit (shkronja "ç"); heqja e masës së sekuestros nga dega e thesarit në çastin e paraqitjes së një grafiku të pagesës së vendimit gjyqësor dhe shlyerjes pjesore të detyrimit, nëse njëzia debitorë nuk ka fonde të mjaftueshme në zërin e shpenzimeve operative të vitit buxhetor, apo kur ka vendim gjykate për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit ose ndarjen e detyrimit në këste (shkronja "d").

2. Individë të ndryshëm, kreditorë ndaj institucioneve buxhetore, ndaj të cilëve, në zbatim të udhëzimit nr. 2/2011, është aplikuar ekzekutimi me këste i detyrimeve që kanë rrjedhur nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, i janë drejtuar me ankesa Avokatit të Popullit, duke pretenduar se zbatimi i këtij udhëzimi i ka cenuar në të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm. Avokati i Popullit, bazuar në këto ankesa, fillimisht i ka rekomanduar Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave ndryshimin e këtij udhëzimi dhe, në vijim, me kërkesën e datës 30.4.2013, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të udhëzimit nr. 2/2011 të Këshillit të Ministrave.

3. **Kërkuesi, Avokati i Popullit**, në mbështetje të pretendimeve të tij për jokushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar, paraqiti këto argumente:

3.1 Udhëzimi nr. 2/2011 cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Dhënia e kompetencës personit të tretë (dega e thesarit), në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në mënyrë detyruese, për vendosjen apo heqjen e masës së sekuestros, mbi llogarinë e debitorit, në rast të paraqitjes, nga ana e këtij të fundit, të grafikut të pagesës, cenon këtë të drejtë për shkak të vonesës në ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.

3.2 Udhëzimi nr. 2/2011 cenon parimin e hierarkisë së akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përcaktimet e bëra në të vijnë ndesh me nenet 116/1 dhe 118 të Kushtetutës, pasi jo vetëm rregullojnë çështje që eventualisht janë rregulluar nga akte normative më të larta në hierarki, por tejkalojnë caqet dhe fushën e rregullimit të dhënë nga

akti normativ, mbi bazën e të cilit ka dalë ky udhëzim. Ky i fundit merr fuqinë dhe efektivisht zëvendëson dispozitat e KPC-së, pasi kompetenca që i është dhënë personit të tretë për vënien apo heqjen e masës së sekuestros mbi llogarinë e palës debitorë është atribut vetëm i Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor Shtetëror, apo Privat, i parashikuar shprehimisht në dispozitat përkatëse të KPC-së. Detyrimi ligjor për personin e tretë, dega e thesarit, është respektimi i detyrimit nga çasti i marrjes dijeni të lajmërimit për vendosjen e masës së sekuestros prej përmbaresit gjyqësor, dhe jo respektimi i përcaktimeve të pikës 7/ç të udhëzimit. Sipas dispozitave të KPC-së, gjykata është organi që ka atributin e shtyrjes së afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla, ose ta ndajë këtë detyrim në këste, dhe jo pala debitorë, sikurse parashikohet në udhëzimin nr. 2/2011.

3.3 Udhëzimi nr. 2/2011 cenon parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës. Dhënia e kompetencës personit të tretë (dega e thesarit apo banka e nivelit të dytë) për vendosjen e masës së sekuestros mbi llogarinë e debitorit, përjashtimin e zërave (artikujve të llogarisë) të debitorit nga sekuestrimi apo kërkimin e akteve, sikurse është përcaktuar në pikën 7/a të udhëzimit, bie në kundërshtim me këtë parim, pasi asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese, sikurse Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor.

3.4 Udhëzimi nr. 2/2011 cenon parimin e barazisë përpara ligjit, i sanksionuar në nenin 18/1 të Kushtetutës. Njohja e së drejtës së debitorit (institucionit buxhetor) për ndarjen në këste të detyrimit, i vendos subjektet në pozita të pabarabarta, për faktin se kjo e drejtë, e njohur institucionit buxhetor debitor, nuk i njihet dhe një subjekti debitor privat.

4. **Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë**, të përfaqësuara nga Avokatura e Shtetit, në parashtrimet e tyre paraqitën këto prapësime:

4.1 Kërkuesi, në thelbin e pretendimeve të tij, nuk ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për ushtrimin e një kontrolli kushtetutshmërie, por të një kontrolli ligjshmërie të udhëzimit objekt kërkese. Kërkuesi pretendon se, fakti që udhëzimi objekt kërkese është në kundërshtim me ligjin (KPC-në dhe ligjet që rregullojnë shërbimin përmbaramor), pra i jashtëligjshëm, e bën atë edhe jokushtetues. Ushtrimi i një kontrolli ligjshmërie nuk përfshihet në kompetencat lëndore të Gjykatës Kushtetuese dhe, për pasojë, ajo nuk mund të investohet me verifikimin e pajtueshmërisë së udhëzimit objekt kërkese me ligjet e tjera, qofshin këto ligje të miratuara

me shumicë të cilësuar. Ligji për gjykatat administrative i mundëson individëve, persona fizikë, vënien në lëvizje të këtyre gjykatave për kontrollin e pajtueshmërisë së një akti administrativ normativ me ligjin. Nëse ky kontroll ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, atëherë përjashtohet mundësia që ai të ushtrohet përsëri nga gjykatat administrative dhe, për pasojë, cenohet akses i individit në gjykatë.

4.2 Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas kërkesit kjo e drejtë cenohet pasi dhënia një personi të tretë (dega e thesarit) e së drejtës për heqjen e sekuestros shkakton vonesë në ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Udhëzimi nr. 2/2011 kufizohet në inkuadrimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në llogarinë e thesarit, rrjedhimisht ekzekutimi mund të zhvillohet normalisht mbi shumat e ndodhura pranë llogarive bankare pranë bankave ose pranë të tretëve. Po ashtu, mekanizmi i së drejtës civile për pagesën me anë të kompensimit (nenet 514 e vijim të KPC-së) mund të operohet edhe ndaj personave publikë. Shteti i shërben interesit publik, ndaj është legjitime që të përfitojë një mbrojtje specifike për aktivitetet e interesit publik.

4.3 Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së akteve normative, Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar në mënyrë shumë të qartë se garantimi i hierarkisë ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore është detyrë e gjykatave të zakonshme, të cilat duhet të zbatojnë ligjin mbi aktin nënligjor. Rrjedhimisht, individët që i janë drejtuar kërkesit kishin mundësinë t'u drejttoheshin gjykatave për shfuqizimin e akteve të nxjerra në zbatim të udhëzimit nr. 2/2011.

4.4 Pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kërkuesi e bazon në argumentin se udhëzimi nr. 2/2011 prek objektin e veprimtarisë së shërbimit përmbarimor. Shërbimi përmbarimor nuk është një organ kushtetues, por përmbaruesi gjyqësor është një ofiqar publik, i cili kryhen funksione të caktuara me ligj. Pretendimi i kërkesit se Gjykata Kushtetuese duhet të investohet me një konflikt kompetencash ndërmjet institucioneve të rregulluara jo drejtpërdrejt nga Kushtetuta, por me ligj të veçantë, është absurd.

4.5 Kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, pasi ai është vënë në lëvizje nga ankesa të paraqitura nga kreditorë, të cilët zotërojnë një vendim gjyqësor të ekzekutueshëm, ndërkohë që pretendimi i tij i referohet një diskriminimi potencial ndërmjet debitorëve publikë dhe privatë. Në çështjen konkrete, kërkuesi nuk po mbron të drejtat e debitorëve privatë por ato të kreditorëve. Mbajtja e një qëndrimi të ndryshëm do të shndërronte *de facto* kërkuenin në një subjekt të pakufizuar mbrojtës edhe të interesave të individëve që nuk kanë paraqitur ankesë pranë tij.

5. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, në parashtrimet e tij paraqiti këto prapësime:

5.1 Avokati i Popullit nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Ky subjekt duhet të veprojë për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, dhe të mos marrë rolin procedural të përfaqësuesit të një personi juridik dhe të një shtetasi, duke përcjellë pretendimet e tyre për një gjykim abstrakt kushtetues. Legjislati në fuqi njeh të drejtën e rishikimit gjyqësor të procesit të zbatimit të këtij akti nënligjor nga organet e administratës. Rrjedhimisht, mund të thuhet se kjo çështje mund të vinte në Gjykatën Kushtetuese prej gjykatave të sistemit të zakonshëm dhe jo nga Avokati i Popullit.

5.2 Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, gjatë hartimit të udhëzimit është marrë në konsideratë interpretimi i bërë në vendime të shumta të Gjykatës Kushtetuese. Nxjerrja e këtij udhëzimi ka pasur si qëllim të balancojë të drejtën themelore të individit për një proces të rregullt ligjor, me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit dhe kryerjen në mënyrë të rregullt të funksioneve publike nga institucionet shtetërore. Përjashtimi i kategorive të veçanta të zërave buxhetore, nga vendosja e masës së sekuestros, është i lidhur ngushtësisht me funksionimin jetik të institucioneve, të cilat, edhe pse mund të zgjidhin pagesën e një vendimi gjyqësor, mund të shndërrohen në një mjet potencial për mosfunksionimin efektiv të institucioneve shtetërore, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizimin e interesit publik.

5.3 Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të hierarkisë së akteve normative, ky akt ka dalë në kuadër të rezervës ligjore absolute për të bërë të mundur zbatimin e KPC-së, përfundim që gjen mbështetje të hapur në nenin 589/4 të Kodit. Akti nënligjor i kundërshtuar, jo vetëm që është në përputhje të plotë me paragrafin e parë të nenit 118 të Kushtetutës, por plotëson edhe kushtet e paragrafit të dytë të së njëjtës normë, pasi KPC-ja: autorizon nxjerrjen e aktit nënligjor të llojit "udhëzim i Këshillit të Ministrave"; përcakton Këshillin e Ministrave si organin kompetent për nxjerrjen e akteve nënligjore në respektim të nenit 589/4; delegon rregullimin me udhëzim të ekzekutimit të detyrimeve në të holla të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.

5.4 Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, për arsye se nuk bën pjesë në interesat e tij fakti se cili organ i është caktuar apo i përket kompetenca ligjore përkatëse.

5.5 Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuesi nuk ka arritur të

shpjegojë, në mënyrë konkrete, se cila është ajo e drejtë apo ajo liri e kreditorëve, e cila është trajtuar në mënyrë “diskriminuose” apo “të pabarabartë përpara ligjit”, dhe krahasuar me kë subjekt tjetër të drejtash apo lirish kushtetuese, që e gëzon këtë trajtim “preferencial”. Nëse ka kufizim të këtij parimi, këtë e ka vendosur vetë neni 589 i KPC-së, në zbatim të të cilit ka dalë akti objekt shqyrtimi. Megjithatë, ky kufizim i vendosur me ligj i plotëson të gjitha standardet e vendosura nga Kushtetuta dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

## II

### A. Lidhur me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

6. Subjektet e interesuara kanë pretenduar se kërkuesi ka kërkuar kontrollin e ligjshmërisë të udhëzimit të kundërshtuar, por jo kontrollin e kushtetutshmërisë së tij, çka nuk përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) dhe, për pasojë, ajo nuk mund të investohet me verifikimin e pajtueshmërisë së udhëzimit objekt kërkese me ligjet e tjera, qofshin këto të miratuara me shumicë të cilësuar. Po ashtu, ata pretendojnë se ligji për gjykatat administrative i mundëson individëve, persona fizikë, vënien në lëvizje të këtyre gjykatave për kontrollin e pajtueshmërisë së një akti administrativ normativ me ligjin. Nëse ky kontroll ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, atëherë përjashtohet mundësia që ai të ushtrohet përsëri nga gjykatat administrative dhe, për pasojë, cenohet akses i individit në gjykatë.

7. Gjykata vëren se Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në kompetencën lëndore të gjykatave administrative përfshihet, mes të tjerash, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lindin nga aktet nënligjore normative të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik (neni 7), duke bërë përjashtim ato mosmarrëveshje të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese (neni 8). Sipas nenit 70/5 të ligjit, data e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, i cili bën propozimin pasi të jenë plotësuar kërkesat e pikës 2 të këtij neni dhe të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në zbatim të kësaj dispozite, bazuar në propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013, në të cilin ka përcaktuar datën 4.11.2013 si ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, e cila shënon fillimin e efekteve të plota juridike të këtij ligji dhe të funksionimit të gjykatave administrative. Pra, në momentin e gjykimin të kësaj çështjeje në Gjykatën

Kushtetuese, gjykatat administrative nuk kishin filluar ende të ushtronin funksionin e tyre.

8. Bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, kontrolli i papajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, është pjesë e juridiksionit kushtetues, kurse pretendimet për përplasje dhe papajtueshmëri midis dy ligjeve të ndryshme apo midis ligjeve dhe kodeve, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, pasi mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004; nr. 35, datë 10.10.2007; nr. 2, datë 3.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës me të cilën ngrihet çështja e kushtetutshmërisë përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimin kushtetues. Në lidhje me objektin e kërkesës, konstatohet se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të udhëzimit nr. 2/2011, kurse për sa i përket shkaqeve të kërkesës, edhe pse kërkuesi bën një analizë të udhëzimit të kundërshtuar, duke e krahasuar atë me rregullimet e KPC-së si dhe kompetencat ligjore që i njihen organit përmbartimor, në thelb të pretendimeve të tij, ai ka arritur të argumentojë se parashikimet e këtij akti, sjellin cenimin e disa parimeve kushtetuese, si ai i hierarkisë së akteve, ndarjes së pushteteve, barazisë para ligjit, si edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura nga kërkuesi, duke qenë se kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e përmbajtjes së aktit të kundërshtuar me parimet kushtetuese, hyjnë në juridiksionin kushtetues.

### B. Lidhur me legjitimitimin e Avokatit të Popullit

10. Gjykata vëren se neni 134/1, shkronja “dh”, i Kushtetutës, e ka vendosur Avokatin e Popullit në rrethin e subjekteve që mund të iniciojnë një gjykim kushtetues abstrakt të normës, por sipas pikës 2 të po këtij neni, kjo e drejtë kufizohet vetëm për çështjet që lidhen me interesat e këtij subjekti. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pra, edhe interesi i tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur, si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve, apo edhe kur shkelja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit vjen si rezultat i vetë përmbajtjes së këtyre ligjeve apo akteve, d.m.th. kur ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë



shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Në këtë rast ai ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënese të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve apo të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'u drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike dhe se është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve nëse një normë është *prima facie* si antikushtetuese (*shih vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, përdorja e kërkesës është në zbatim të funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta, ai legjitimohet *ratione personae*.

11. Kërkesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është regjistruar në Gjykatë brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Udhëzimi nr. 2, datë 18.8.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 28.9.2011, dhe ka hyrë në fuqi pas botimit të tij, kurse kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 30.4.2013.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, shqyrtohet rast pas rasti. Ky interes do të quhet i justifikuar nëse arrin të provohet se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale dhe, sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit (*shih vendimet nr. 40, datë 16.11.2007; nr. 10, datë 18.3.2013; nr. 14, datë 17.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, kërkesi pretendon se përmbajtja e aktit të kundërshtuar, në të cilën parashikohet e drejta e degës së thesarit për heqjen e masës së sekuestros në rast të paraqitjes nga ana e institucionit buxhetor debitor të një grafiku pagese me këste të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, sjell cenim të së drejtës për një proces të rregullt të individëve që përfitojnë nga këto vendime. Cenimi është aktual dhe jo potencial, pasi, zbatimi i këtij Udhëzimi ka sjellë pengesa në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm. Po ashtu, ekziston edhe lidhja e drejtpërdrejtë me subjektin. Në rastin konkret, Avokati i Popullit është vënë në lëvizje nga shtetas të

ndryshëm të cilët nuk kanë arritur të ekzekutojnë tërësisht vendimet gjyqësore të dhëna në favor të tyre dhe, për këtë qëllim, ai ka vënë në dispozicion të Gjykatës edhe ankesat që i janë paraqitur. Nga korrespondencat e këtij organi me institucione buxhetore debitorë, evidentohet se në mungesë të fondeve për ekzekutimin tërësor, detyrimet shlyhen në këste, në bazë të udhëzimit nr. 2/2011. Në këto kushte, kërkesi ka krijuar bindjen se këto vonesa janë pasojë e zbatimit të këtij udhëzimi dhe se shfuqizimi i tij mund të sjellë, si pasojë, rivendosjen e së drejtës së individit për një proces të rregullt. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja konkrete lidhet me interesin e kërkesit për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit dhe ai legjitimohet për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe, lidhur me këtë të drejtë, edhe për pretendimin për mosrespektimin e hierarkisë së akteve ligjore, të parashikuar në nenin 118 të Kushtetutës.

14. Lidhur me pretendimet për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve (neni 7 i Kushtetutës), dhe atij të barazisë përpara ligjit (neni 18 i Kushtetutës), Gjykata vlerëson se argumentet e kërkesit nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe, për rrjedhojë, ajo nuk mund të investohet në shqyrtimin e tyre. Pretendimin për cenimin e nenit 7 të Kushtetutës, kërkesi e bazon në vlerësimin se udhëzimi nr. 2/2011 prek objektin e veprimtarisë së shërbimit përmbarimor, por pa argumentuar lidhjen e këtij fakti me cenimin të drejtave të individit, për të justifikuar interesin e tij, në kuptim të nenit 60 të Kushtetutës. Lidhur me pretendimin për cenimin e nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se kërkesi nuk ka arritur të argumentojë, në nivel kushtetues, se Këshilli i Ministrave, me miratimin e këtij udhëzimi, ka shkaktuar një pabarazi ligjore ndërmjet subjekteve të cilave u drejtohet, në mungesë të një përligjeje të arsyeshme dhe objektive.

#### ***C. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor***

15. Kërkesi pretendon se udhëzimi nr. 2/2011 cenon nenin 42 të Kushtetutës, për arsye se dhënia e kompetencës personit të tretë (dega e thesarit), për vendosjen apo heqjen e masës së sekuestros, mbi llogarinë e debitorit, në rast të paraqitjes, nga ana e këtij të fundit, të grafikut të pagesës, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, për shkak të vonesës në ekzekutimin e një titulli ekzekutiv.

16. Gjykata vëren se, edhe pse kërkesi, në objekt të kërkesës, ka kërkuar shfuqizimin e të gjithë aktit të kundërshtuar, ai ka arritur të ngrëjë në nivel kushtetues vetëm pretendimet që lidhen me përmbajtjen e shkronjës "d" të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, ndaj është pikërisht ky parashikim ligjor që do të bëhet objekt i kontrollit kushtetues.

17. Gjykata thekson se parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), si dhe detyrimi për organet shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (neni 142/3 i Kushtetutës), nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Në këtë kuptim, ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë është konsideruar pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 17, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ajo që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë (*shih vendimin nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.

19. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjykimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 23, datë*

*17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 17, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sistemi ligjor shqiptar është organizuar në mënyrë të tillë që ka parashikuar edhe krijimin e strukturave të tjera, të ngarkuara për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sipas dispozitave të KPC-së, Kodit Civil, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, dhe për këtë qëllim, përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 13, datë 21.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Dispozitat e KPC-së përcaktojnë procedurat ligjore të përgjithshme, të cilat duhen ndjekur për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Neni 510 parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe se janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera, vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Neni 511 parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata, i cili vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor ndër të tjera edhe me kërkesën e kreditorit (neni 515). Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të bëhet fillimisht me ekzekutim vullnetar, kritere që parashikohen nga neni 517 i Kodit, kurse neni 519 i tij parashikon kriteret për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Përveç sa më sipër, KPC-ja ka parashikuar edhe procedura të posaçme ekzekutimi në varësi të llojit të sendeve (sende të luajtshme, të paluajtshme), llojit të të drejtave (kredi e debitorit, sende që të tretët i detyrohen debitorit) apo në varësi të subjekteve debitorë (privat ose shtetëror). Për sa i përket kësaj të fundit, në kreun V të Kodit janë parashikuar rregullat që ndiqen për ekzekutimin e detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore. Neni 589 i KPC-së parashikon se ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit dhe se nuk lejohet ekzekutimi i detyrueshëm mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të institucionit buxhetor. Në rast se institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi te të tretët dhe as në thesar, dispozita parashikon se ai i drejtohet organit epror financiar përkatës për të caktuar fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit.

21. Gjykata vlerëson se ligjvënësi ka përcaktuar për institucionet buxhetore, në cilësinë e tyre si debitor, procedura të posaçme ekzekutimi për faktin se ato ushtrojnë pushtete specifike dhe ekskluzivisht të

atribuara atyre, duke pasur si qëllim mbrojtjen e funksionit publik. Duke kufizuar hapësirën ku mund të ndërhyhet për ekzekutimin e detyrueshëm dhe duke përjashtuar ato pasuri që janë të destinuara për një shërbim publik ose për kryerjen e funksioneve institucionale, ligjvënësi ka synuar evitimin e bllokimit të aktivitetit administrativ, që mund të shkaktohej si pasojë e bllokimeve të përsëritura të fondeve në llogaritë në thesar të këtyre institucioneve.

22. Në paragrafin e fundit të nenit 589 të KPC-së autorizohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e udhëzimeve për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit. Në bazë të këtij delegimi është miratuar udhëzimi nr. 2/2011, i cili përcakton mënyrën e ekzekutimit të këtyre detyrimeve në llogari të thesarit, dokumentacionin e nevojshëm që duhet paraqitur për këtë qëllim, afatet, detyrimet dhe kompetencat e secilit subjekt pjesëmarrës në këtë procedurë, si edhe artikullin buxhetor ku vendoset sekuestro (artikulli 602), duke parashikuar se nuk mund të preken shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit, si energji, ujë dhe materiale e shërbime speciale (artikulli 6021). Pika 7 e udhëzimit rregullon, specifikisht, procedurën që ndiqet në rast të fillimit të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe paraqitjes, nga ana e përmbaruesit, të kërkesës për vendosjen e masës së sekuestros. Mes, të tjerash, në shkronjën “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, parashikohet se *“Masa e sekuestros hiqet, nga drejtuesi i degës së thesarit: - në çastin e paraqitjes së një grafiku të pagesës së vendimit gjyqësor dhe shlyerjes pjesore të detyrimit, nëse njësia debitore nuk ka fonde të mjaftueshme në zërin e shpenzimeve operative të vitit buxhetor aktual, apo; - kur ka vendim gjykate, për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit ose ndarjen e detyrimit në këste.”*

23. Gjykata vëren se, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, *“sistem i thesarit”* është tërësia e rregullave dhe e procedurave, si dhe struktura organizative përkatëse, e ngarkuar për ekzekutimin e buxhetit, administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive dhe raportimin financiar të qeverisjes së përgjithshme (neni 3), kurse llogari e thesarit konsiderohet llogaria e unifikuar e thesarit në Bankën e Shqipërisë (neni 8). Angazhimet dhe detyrimet financiare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme paguhen vetëm nga llogaritë e thesarit dhe përpara kryerjes së pagesave, sistemi i thesarit kontrollon: a) ekzistencën e angazhimit; b) dokumentacionin bazë, që vërteton shërbimin e kryer; c) ekzistencën e mjeteve monetare të mjaftueshme për kryerjen e pagesës (neni 54). Në këtë kuptim, udhëzimi nr. 2/2011, nëpërmjet përcaktimit të detajuar të procedurave që duhen ndjekur

dhe detyrimeve që rrjedhin për drejtuesit e degëve të thesarit në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, synon të garantojë mirëadministrimin e mjeteve monetare të shtetit, thelbësore për ushtrimin e funksioneve të tij publike, që është edhe detyra kryesore e strukturave të ngarkuara me zbatimin e buxhetit të shtetit.

24. Në lidhje me organet e ekzekutimit të detyrueshëm, Gjykata thekson se shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, është një funksion i pavarur, me karakter publik, dhe ai është ngarkuar nga ligji për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e KPC-së. Mes të tjerash, në ushtrimin e funksionit të tij, përmbaruesi ka të drejtën e vendosjes së masës së sekuestros mbi pasuritë e debitorit, si një nga mjetet procedurale që mundëson ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Institucionet shtetërore nuk përjashtohen nga ekzekutimi i detyrimeve dhe ndaj tyre zbatohet parimi i përgjegjësisë pasurore. Zyra e përmbarimit duhet të ekzekutojë detyrimin e debitorit ndaj kreditorit edhe nëse debitori është një institucion buxhetor, ashtu siç vepron në rastet kur debitorë janë subjekte private dhe se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto privatë apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj (*shih vendimet nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 21, datë 21.7.2009; nr. 16, datë 4.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se asnjë organ i administratës publike nuk mundet që duke ushtruar autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë. Përkundrazi, këto organe, si çdo subjekt tjetër palë e një gjykimi, kanë të drejtë që të kundërshtojnë në gjykatë ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të mjeteve mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni në fuqi (*shih vendimin nr. 42, datë 19.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbajtja e paragrafit të parë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, e cila i njeh drejtuesit të degës së thesarit të drejtën të heqë masën e sekuestros të vendosur nga përmbaruesi gjyqësor, vetëm me paraqitjen e një grafiku ekzekutimi nga ana e institucionit debitor, sjell pasojë të drejtpërdrejta në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, drejtuesi i zyrës së thesarit nuk ka diskrecion apo kompetencë të vlerësojë lidhur me vendosjen e masës së sekuestros në rast se ajo kërkohet nga përmbaruesi, por roli i këtij subjekti përqendrohet në verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga përmbaruesi dhe zbatimin e

procedurave të parashikuara në udhëzim, si dhe marrjen e masave që masa e sekuestros të mos prekë shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit. Shtyrja e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarja e tij në këste, për shkak të pamundësisë paguese të debitorit, parashikohet në nenin 517/3 të KPC-së dhe mund të bëhet vetëm me vendim gjyqësor. Në këtë kuptim, këtij subjekti (dega e thesarit) nuk i njihet e drejta të kryejë një ekzekutim pjesor apo të shtyjë atë pa pëlqimin e kreditorit, apo pa paraqitur debitori një vendim gjyqësor për këtë qëllim. Përmbajtja e paragrafit të parë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, i njeh të drejtën si debitorit, ashtu edhe drejtuesit të degës së thesarit, që në mënyrë të njëanshme, vetëm me paraqitjen e një grafiku për ekzekutimin e detyrimit nga ana e njësisë debitore, pa përcaktuar asnjë afat për shlyerjen tërësore të detyrimit, apo një kufi të vlerës minimale të pagueshme, të shtyjë, në një afat të pacaktuar, ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke humbur, për pasojë, edhe qëllimi i fitimit të vetë së drejtës së kreditorit. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashikimi i paragrafit të parë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011 të Këshillit të Ministrave, është i papajtueshëm me nenin 42 të Kushtetutës.

26. Gjykata vëren se në paragrafin e dytë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, është parashikuar heqja e masës së sekuestros nga drejtuesi i degës së thesarit, edhe në rastin kur paraqitet një vendim gjykate, për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit ose ndarjen e tij në këste. Neni 527 i KPC-së e ka parashikuar masën e sekuestros si një ndër masat shtrënguese për ekzekutimin e detyrueshëm të ekzekutimit të vendimit, duke respektuar, në rastin e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore, urdhërimet e nenit 589 të KPC-së, kurse shtyrja e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarja e tij në këste, për shkak të pamundësisë paguese të debitorit, parashikohet në nenin 517/3 të KPC-së. Ky parashikim ligjor gjen pasqyrim në pikën 8 të udhëzimit, sipas të cilit, në rastet kur njësia shpenzuese debitore, me fondet buxhetore që ka në dispozicion, nuk është në gjendje të shlyejë asnjë pjesë të detyrimit sipas vendimit gjyqësor, i drejtohet gjykatës për shlyerjen pjesore me fondet e vitit/viteve në vijim dhe në rast të pranimit të kërkesës, një kopje e vendimit gjyqësor paraqitet nga njësia shpenzuese në degën e thesarit, e cila merr masa dhe e regjistron si angazhim buxhetor të debitorit. Gjykata vlerëson se, ndërsa kërkesa e debitorit për ekzekutimin në këste apo shtyrjen e ekzekutimit presupozon mungesën e fondeve për shlyerjen e detyrimit, vendosja e sekuestros ka si qëllim ngrirjen e fondeve ekzistuese, deri në masën e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Në këtë kuptim, e

drejta e degës së thesarit, për heqjen e masës së sekuestros, pa parashikuar mënyrën se si zbatohet ajo dhe deri në çfarë mase, nuk plotëson kërkesën për saktësi dhe parashikueshmëri që përmban koncepti i një rregullimi ligjor. Mungesa e rregullimit ligjor dhe paqartësitë që sjell përmbajtja e paragrafit të dytë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, i lë shteg zbatuesit që t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe, për pasojë, krijon hapësira për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Si përfundim, Gjykata vlerëson se edhe parashikimi i paragrafit të dytë të shkronjës “d” të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, është i papajtueshëm me nenin 42 të Kushtetutës.

#### ***D. Lidhur me pretendimin për cenimin e nenit 17 dhe 118 të Kushtetutës***

27. Kërkuesi pretendon se përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 2/2011 vijnë ndesh me nenin 116/1 dhe 118 të Kushtetutës, pasi jo vetëm rregullojnë çështje që eventualisht janë rregulluar nga akte normative më të larta në hierarki, por tejkalojnë caqet dhe fushën e rregullimit të dhënë nga akti normativ, mbi bazën e të cilit ka dalë ky udhëzim.

28. Në kushtet kur Gjykata vlerësoi se përmbajtja e pikës 7 të udhëzimit objekt gjykimi, cenon nenin 42 të Kushtetutës, ajo do të ndalet në vlerësimin nëse ky kufizim është bërë në përputhje me përmbajtjen e neneve 17 dhe 118 të Kushtetutës.

29. Gjykata ka theksuar se për të justifikuar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte, siç janë ato që kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore (*shih vendimet nr. 10, datë 19.3.2008; nr. 12, datë 28.4.2009; nr. 52, datë 5.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i nenit 17 të Kushtetutës është që në rastin e kufizimeve, jo vetëm duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht, organi më i lartë ligjvënës. Shprehja “*vetëm me ligj*” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave (*shih vendimet nr. 20, datë 11.7.2006; nr. 12, datë 28.4.2009; nr. 24, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo shprehje referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhëniet e tilla, cenon kompetencat e këtij organi (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas paragrafit të parë të nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve, ndërsa paragrafi i dytë i po këtij neni përcakton se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Kjo dispozitë kushtetuese nuk lejon organin përkatës të administratës shtetërore që të nxjerrë një akt nënligjor, nëse ligji nuk ka autorizuar nxjerrjen e aktit, organin kompetent, çështjen që do të rregullojë akti dhe parimet në bazë të të cilit ai do të nxirret.

31. Gjykata ka theksuar se në rastin e *rezervës ligjore absolute* është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin e *rezervës ligjore relative* çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore (*shih vendimet nr. 20, datë 11.7.2006; nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t'u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe nga ana tjetër orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore (*shih vendimin nr. 7, datë 27.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata vlerëson se udhëzimi nr. 2/2011 ka dalë në zbatim të nenit 589/4 të KPC-së, i cili parashikon se Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit. Siç u përmend më sipër, ky akt nënligjor ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të këtyre detyrimeve nga llogaria e thesarit e institucioneve buxhetore, dokumentacionin e nevojshëm që duhet paraqitur për këtë qëllim, afatet, si edhe detyrimet dhe kompetencat e secilit subjekt pjesëmarrës në këtë procedurë. Në pikën 7, shkronja "d" të tij, udhëzimi nr. 2/2011 ka parashikuar të drejtën e drejtuesit të degës së thesarit për heqjen e masës së sekuestros në rastin kur paraqitet një grafik ekzekutimi apo një vendim gjyqësor për shlyerjen në këste apo shtyrjen e afatit të detyrimit.

33. Neni 517 i KPC-së parashikon se me kërkesë të debitorit, gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste. Në këto kushte, përmbajtja e shkronjës "d" të pikës 7 të udhëzimit të kundërshtuar, përfaqëson një kufizim të ri në të drejtën për proces të rregullt ligjor. Neni 17/1 i Kushtetutës i ka rezervuar ligjit kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë, duke parashikuar edhe kushtet që duhet të plotësojë një kufizim i tillë, ndaj parashikimi në shkronjën "d" të pikës 7 të udhëzimit nr. 2/2011, të një kufizimi të ri, përtej atyre të parashikuar nga dispozitat e KPC-së, nuk respekton kriterin e kufizimit me ligj të së drejtës, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës. Kompetenca që i është njohur degës së thesarit për heqjen e masës së sekuestros, përbën një tejkalim të çështjeve të cilat ligji ka autorizuar Këshillin e Ministrave të rregullojë. Në këto kushte, tejkalimi i kompetencave që ligji i ka deleguar Këshillit të Ministrave, duke rregulluar me akt nënligjor një marrëdhënie që i përket rezervës ligjore absolute, bie ndesh edhe me parashikimet e 118 të Kushtetutës.

34. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashikimi i shkronjës "d" të pikës 7 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", bie ndesh me nenet 17, 42 dhe 118 të Kushtetutës dhe, si i tillë, duhet të shfuqizohet.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "c", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
  - Shfuqizimin, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d" të pikës 7 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit".
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

## MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Avokatin e Popullit, me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se Gjykata nuk duhej ta merrte këtë çështje në shqyrtim, për shkaqet që do parashtrijmë në vijim.

2. Në vendimin e saj shumica ka vlerësuar se edhe pse kërkuesi bën një analizë të udhëzimit të kundërshtuar, duke e krahasuar atë me rregullimet e KPC-së, si dhe kompetencat ligjore që i njihen organit përmbarrimor, në thelb të pretendimeve të tij, ai ka arritur të argumentojë se parashikimet e këtij akti sjellin cenimin e disa parimeve kushtetuese (*paragrafi 9 i vendimit*).

3. Subjektet e interesuara paraqitën para Gjykatës pretendime lidhur me juridiksionin e saj për shqyrtimin e kësaj çështjeje, duke argumentuar se kërkuesi ka kërkuar kontrollin e ligjshmërisë së udhëzimit të kundërshtuar, por jo kontrollin e kushtetutshmërisë së tij, çka nuk përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës Kushtetuese. Ne, gjyqtarët në pakicë, mendojmë se ky pretendim është i bazuar. Po t'i referohemi kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit, rezulton qartësisht se ajo është thjesht një analizë e udhëzimit të kundërshtuar, krahasuar me parashikimet e KPC-së që rregullojnë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe kompetencat ligjore që i njihen organit përmbarrimor në këtë proces, pra në tërësinë e saj kërkesa ka ardhur në Gjykatë si një përplasje mes akteve ligjore dhe atyre nënligjore në fuqi. Edhe pse në konkluzionet e vendosura në fund të kërkesës së tij, kërkuesi ka rreshtuar disa të drejta e parime kushtetuese, të cilat pretendon se cenohen nga akti i kundërshtuar, kjo nuk është e mjaftueshme për Gjykatën për të vlerësuar se kjo çështje hyn në juridiksionin e saj. Gjykata Kushtetuese nuk vihet në lëvizje kryesisht, por ajo duhet të investohet nga subjektet që mund t'i drejtohen asaj, të cilat, përveç argumentimit të legjitimitetit të tyre (në rast të subjekteve të kushtëzuara), duhet të paraqesin argumente kushtetuese për të provuar pretendimet e tyre. Prosesi kushtetues është një proces edhe i të provuarit dhe, në këtë kuptim, çdo kërkesë duhet të shoqërohet me argumentet kushtetuese përkatëse.

4. Gjykata ka theksuar se kontrolli i papajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare është pjesë e juridiksionit kushtetues, kurse pretendimet për përplasje dhe papajtueshmëri midis dy ligjeve të ndryshme apo midis ligjeve dhe kodeve, nuk janë objekt shqyrtimi

nga Gjykata Kushtetuese, në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, pasi mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues. Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesit lidhen me paligjshmërinë e përmbajtjes së aktit të kundërshtuar përballë rregullimeve të KPC-së, kontroll ky që mund të ushtrohet nga gjykata e zakonshme, por që nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues.

5. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Nëse gjyqtari, gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kontrolli i ligjshmërisë së aktit nënligjor është kompetencë që ushtrohet nga juridiksioni gjyqësor i zakonshëm, çka do të thotë se gjykatat nuk kanë asnjë pengesë që të mos zbatojnë normat e aktit nënligjor, si akt më i ulët, në rast të një konflikti të mundshëm, nëse vlerësojnë se ato bien ndesh me rregullimet e KPC-së.

6. Jo vetëm kaq, por me miratimin e ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në kompetencën lëndore të gjykatave administrative përfshihet, mes të tjerash, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lindin nga aktet nënligjore normative të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik (neni 7). Të drejtën e ngritjes së padisë, sipas nenit 15 të ligjit, e ka çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik, si dhe çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ. Objekti i padisë ngrihet për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ, si dhe për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ (neni 17).

7. Ndaj, duke iu referuar sërish pretendimeve të kërkuesit, vlerësojmë se në thelb ato lidhen me mënyrën se si zbatohet akti i kundërshtuar. Potencialisht, fondet në llogarinë e thesarit të institucionit buxhetor mund të mos jenë të mjaftueshme, prandaj akti ka parashikuar që në të tilla raste mund të miratohet një grafik pagesash, por kjo nuk përjashton detyrimin e debitorit që të marrë të gjitha masat për parashikimin në buxhetin pasardhës të detyrimit, me qëllim shlyerjen e plotë të tij. Udhëzimi, në asnjë dispozitë të tij, nuk përcakton që grafiku i pagesës së vendimit gjyqësor duhet të jetë disavjeçar dhe fakti që në raste specifike, institucione të ndryshme mund të abuzojnë me këtë të drejtë nuk përbën shkak për antikushtetutshmërinë e udhëzimit. Për më tepër, individit kreditor ka të gjitha hapësirat ligjore për t'iu drejtuar gjykatës së zakonshme për kundërshtimin e aktit administrativ, grafikut të ekzekutimit pjesor të detyrimit, dhe është gjykata ajo që do vlerësojë bazueshmërinë në ligj e prova të tij.

8. Siç rezulton nga përmbajtja e udhëzimit nr. 2/2011, i dalë në zbatim të delegimit të dhënë nga neni 589 i KPC-së, në të është parashikuar më në detaje procedura që ndiqet për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë të dhënë në favor të një individit ndaj një institucioni buxhetor. Udhëzimi, përveç përcaktimit të rregullave që duhet të ndjekin subjektet e përfshira në këtë procedurë dhe detyrimit të institucionit buxhetor për marrjen e masave për ekzekutimin, nëpërmjet degës së thesarit, ka përcaktuar edhe se masa e sekuestros mund të hiqet nga dega e thesarit në rast të paraqitjes së një grafiku ekzekutimi nga ana e institucionit buxhetor.

9. Udhëzimi i kundërshtuar përbën një masë me karakter ligjor në drejtim të përfundimit të procesit gjyqësor, në fazën ekzekutive të tij. Fakti që ai parashikon, si një mundësi për debitorin dhe jo si një detyrim për të, ekzekutimin e detyrimit brenda një periudhe më të gjatë, në varësi të rrethanave konkrete, nuk përfaqëson një kohëzgjatje të tepruar (të paarsyeshme) të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si pasojë e problemeve që shfaq ekzekutimi i titujve ekzekutivë ndaj institucioneve buxhetore (të konstatuara dhe në jurisprudencën e Gjykatës). Edhe GJEDNJ-ja ka vlerësuar se një afat prej 2 vjet e 7 muaj për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor nuk është i paarsyeshëm në kushtet e një çështjeje konkrete, ndaj edhe ky vlerësim i Gjykatës nuk mund të bëhet *a priori*, por rast pas rasti. Udhëzimi nr. 2/2011 nuk pengon ekzekutimin e detyrimeve të institucioneve buxhetore, përkundrazi ai ka detajuar procedurat për ekzekutimin e tyre, duke parashikuar ekzekutimin në disa faza vetëm si një mundësi të ekzekutimit të detyrimit. Ky lloj ekzekutimi nuk është i ndaluar, pasi në vlerësimin tonë, ekzekutimi i menjëhershëm përbën vetëm një formë tjetër ekzekutimi, por kjo nuk do të thotë se është

mënyra e vetme e mundshme e ekzekutimit që mund të zbatohet qeveria.

10. Për sa më sipër, në gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se kontrolli i ligjshmërisë së udhëzimit të kundërshtuar është një çështje që i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe nuk mund të bëhet objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë, ndaj kërkesa e paraqitur nga Avokati i Popullit, për shfuqizimin si të papajtuësëm me Kushtetutën, të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, duhej të rrëzohej.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

**VENDIM**  
**Nr. 21, datë 7.4.2014**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datat 19.12.2013 dhe 16.1.2014, mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 52 Akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Maliq Maliqi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Zyra e Përmbarrimit Tiranë, Studio Përmbarrimore “Debit Collection”

OBJEKTI: Konstatimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 100, datë 15.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, 134/1/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Me vendimin nr. 9 prot., datë 21.1.2010 të kryetares së Komitetit Shqiptar të Birësimeve, ndaj

kërkuesit Maliq Maliqi, i cili punonte në pozicionin e juristit pranë këtij institucioni, është marrë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

2. Ndaj këtij vendimi, kërkuesi ka paraqitur ankim në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC). Ky i fundit, me vendimin nr. 93, datë 25.5.2010, ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 9 prot., datë 21.1.2010, kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës, jurist pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve, si dhe detyrimin e këtij institucioni për të bërë pagesën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 93, datë 25.5.2010 i KSHC-së është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 100, datë 15.10.2010. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga subjekti i interesuar, Komiteti Shqiptar i Birësimit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 25, datë 15.3.2011, ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për zbatimin e vendimit gjyqësor të po kësaj gjykate.

5. Pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, kërkuesi rezulton t'i jetë drejtuar shërbimit përbarimor për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor.

6. Me shkresën e datës 18.1.2012, përbaruesi gjyqësor privat i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, që konsiston në rikthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e pagës që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

7. Me shkresën nr. 28/1 prot., datë 30.1.2012, debitori i ka kthyer përgjigje përbaruesit se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 17, datë 26.1.2012, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-790, datë 5.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

9. Me shkresën nr. 105/1 prot., datë 28.5.2012, përbaruesi gjyqësor privat i është drejtuar sërish debitorit me lajmërim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

10. Me shkresën nr. 268/1 prot., datë 5.6.2012, debitori i ka kthyer përgjigje përbaruesit se ai ka filluar procedurat përkatëse për zbatimin e vendimit gjyqësor. Bashkëlidhur, debitori ka paraqitur edhe një grafik të shlyerjes pjesore të detyrimit, nga ku rezulton se detyrimi total ndaj kërkuesit për periudhën 2010-2012 është në vlerën 1 533 636 lekë, ndërsa deri në gjysmën e vitit 2012 janë shlyer në total 12 500 lekë (viti 2010 – 6 000 lekë, viti 2011 – 6 000 lekë, gjysma e vitit 2012 – 500 lekë).

11. Me urdhrin nr. 23, datë 31.7.2012, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka vendosur lirimin e kërkuesit nga detyra, pasi pozicioni i tij i punës është deklaruar i tepërt, dhe kalimin e tij në listë pritjeje.

12. Rezulton që nga ana e debitorit të jenë bërë disa pagesa në emër të kërkuesit, për vitin 2012, në shumat 99 871 lekë, 49 935 lekë dhe 49 935 lekë.

13. Me vendimin nr. 105/4 prot., datë 21.9.2012, përbaruesi gjyqësor ka vendosur të gjobisë kreun e institucionit debitor në shumën 50 000 lekë, me arsyetimin se nuk është kryer asnjë pagesë në emër të kreditorit.

14. Me shkresën nr. 454/1 prot., datë 8.10.2012, debitori i është përgjigjur përbaruesit gjyqësor se ka shlyer pagesën ndaj kreditorit, sipas grafikut të paraqitur, si edhe se ka kryer pagesën e dy muajve që i takon nga kalimi në listë pritjeje.

15. Me shkresën nr. 105/5 prot., datë 8.10.2012, përbaruesi gjyqësor privat ka urdhëruar vendosjen e sekuestros mbi pagën e drejtueses së institucionit debitor për shlyerjen e masës së gjobës.

## II

16. **Kërkuesi Maliq Maliqi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për këto shkaqe:

16.1 Titullari i institucionit debitor, pasi është njohur me detyrimin e vendosur nga gjykata, ka miratuar urdhrin e lirimit nga kërkuesi, edhe pse ai ende nuk ishte rikthyer në detyrën e mëparshme në zbatim të vendimit gjyqësor.

16.2 Urdhri i Kryeministrit, për organikën e re të institucionit, ku parashikohej të kishte vetëm një jurist, është miratuar disa muaj pasi debitori është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit. Në këto kushte, nuk ka pasur asnjë pengesë për rikthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës.

16.3 Nga debitori, pretendohet se kërkuesi është liruar nga detyra dhe ka kaluar në listë pritjeje me urdhrin nr. 23, datë 31.7.2012, të titullarit të institucionit, por nuk shpjegon se nga cila detyrë është liruar ai në kushtet kur kërkuesi nuk u rikthye asnjëherë në vendin e mëparshëm të punës.

16.4 Kërkuesit i paguhet një shumë prej 12 500 lekësh në muaj, të cilat nuk mjaftojnë për shpenzimet e tij, ndërkohë që detyrimi që debitori duhet të shlyejë është shumë herë më i madh në vlerë.

17. **Subjekti i interesuar, Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB), i përfaqësuar edhe nga Avokatura e Shtetit**, në parashtrimet me shkrim ka prapësuar se:



17.1 Në lidhje me llogaritjen e periudhës së ekzekutimit, kërkuesi, në cilësinë e kreditorit, ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit pas 5 muajsh nga marrja e vendimit të themelit, ndaj kjo periudhë nuk mund t'i ngarkohet si vonesë institucionit, pasi buron nga sjellja neglizhente e vetë kërkuesit. Për sa i përket sjelljes së debitorit, ky subjekt, në përputhje me të drejtat e tij ligjore, ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkesë që është pranuar me vendimin nr. 17, datë 26.1.2012 të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, periudha që duhet të merret parasysh duhet të fillojë nga data 5.4.2012 kur Gjykata e Lartë ka dhënë vendimin për mospranimin e rekursit të paraqitur.

17.2 KSHB-ja ka vepruar në përputhje me vendimin nr. 100/2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për aq sa lejonte ligji dhe struktura e institucionit, duke vijuar me pagesën e pjesëshme të pagave për kohën që kërkuesi nuk ka qenë në punë, ndërkohë që është ezauruar pjesa e dhënies së pagës për kohën që ka qenë në listë pritjeje.

17.3 KSHB-ja i paraqet çdo vit buxhetin, për miratim, Ministrisë së Drejtësisë, e cila bën më pas edhe planifikimin e buxhetit në tërësi të institucioneve të varësisë. Detyrimet që debitori ka ndaj kërkuesit, sipas llogaritjeve të bëra për këtë qëllim, janë në vlerën 1 704 040 lekë. Nga ana e titullarit të mëparshëm të institucionit u mor vendimi që shlyerja e detyrimit të kryhej në pjesë deri në realizimin e plotë, për arsye se fondet operative nuk përballonin likuidimin e menjëhershëm të kësaj shume. Ky likuidim filloi në muajin korrik 2012 dhe deri në muajin tetor 2013 shuma e paguar ishte në vlerën 200 000 lekë. Për arsye se në fund të vitit 2013 institucioni pati një tepicë fondesh të papërdorura, dhe pasi mori miratimin e Ministrisë së Drejtësisë, në favor të kërkuesit u pagua shuma prej 1 100 000 lekësh, çka do të thotë se detyrimi ndaj kreditorit është shlyer në total në masën 1 300 000 lekë dhe do të vijojë deri në ekzekutimin e plotë të tij.

17.4 Në lidhje me pretendimin për suprimimin e vendit të punës së kërkuesit dhe kalimin e tij në listë pritjeje, këto veprime janë në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil, ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit" dhe urdhrin të Kryeministrit nr. 75, datë 2.7.2012 "Për miratimin e organikës së Komitetit Shqiptar të Birësimeve". Në procesin administrativ të zhvilluar në KSHC dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u provua se struktura dhe organika e KSHB-së është hartuar në përputhje me standardet e vendosura në VKM nr. 474, datë 16.6.2011 "Për përcaktimin e standardeve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike". Sipas strukturës së re, u bë një riformatim dhe vendi i

juristit u zëvendësua me atë të specialistit psikolog. Në këto kushte, kërkuesit nuk mund t'i ofrohej një vend i njëjtë, pasi emërtesa dhe përshkrimi i punës kërkonte kritere të tjera, të cilat nuk plotësohen prej tij. Nxjerrja e kërkuesit në listë pritjeje është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe është konkluduar se ajo ishte e ligjshme. Në këto kushte, rezulton se debitori po tregon kujdesin maksimal në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe, për pasojë, kërkuesit nuk i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

18. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 17, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ajo që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë (*shih vendimin nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ

e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt, si në fazën e gjykimit ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm.

20. Për vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Gjykata merr në analizë disa elemente, të cilat janë rrethanat e çështjes dhe kompleksiteti i saj, sjellja dhe interesi i kërkuarit, si dhe sjellja e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata do të ndalet në analizimin e secilit prej këtyre elementeve.

21. Në lidhje me periudhën që duhet të merret në konsideratë, Gjykata vëren se procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm janë vënë në lëvizje nga kërkuari me vendimin nr. 25, datë 15.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. 100, datë 15.10.2010, të po asaj gjykate. Gjykata vëren, gjithashtu, se me vendimin nr. 17, datë 26.1.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, masë provizore që ka qëndruar në fuqi deri në datën 5.4.2012, kur është vendosur mospranimi i rekursit me vendimin nr. 00-2012-790 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pas dhënies së këtij vendimi, zyra e përmbarrimit ka iniciuar përsëri procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe rezultojnë që debitori të ketë nisur ekzekutimin e vendimit, vetëm në lidhje me detyrimin në të holla, duke aplikuar shlyerjen me grafik të tij në masën 12 500 lekë në muaj. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se periudha që duhet marrë në konsideratë, deri në momentin që kërkuari i është drejtuar me kërkesë Gjykatës (7.10.2013), është afërsisht 2 vjet e 4 muaj.

22. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

23. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar dhe nuk rezultojnë që të jetë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

24. Në lidhje me sjelljen e debitorit KSHB-ja, rezultojnë se në momentin e dhënies së vendimit nr. 93, datë 25.5.2010 të KSHC-së (për rikthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës), në organikën e këtij institucioni, sipas urdhrin nr. 96, datë 23.7.2008 të Kryeministrit, përfshihej një vend pune si jurist. Me

urdhrin nr. 113, datë 31.12.2011 të Kryeministrit, është miratuar organika e re e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, duke përcaktuar 8 punonjës në përbërje të tij, ku u përfshinë dy juristë. Sipas parashtrimeve të subjektit të interesuar, në vendin e ri të parashikuar në organikë është emëruar një jurist tjetër, duke u ruajtur i lirë vendi i kërkuarit deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Megjithatë, debitori i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, dhe ky i fundit nuk është ekzekutuar në lidhje me këtë pjesë të detyrimit. Masa e pezullimit ka qëndruar në fuqi deri në datën 5.4.2012 kur është dhënë vendimi i mospranimit nga ana e Kolegjit Civil, kurse me urdhrin nr. 75, datë 2.7.2012 të Kryeministrit, është miratuar organika e re e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, duke u përcaktuar në përbërje të tij vetëm një pozicion pune si jurist. Në këto kushte, kërkuari është kaluar në listë pritjeje për shkak të deklarimit të tepërt të vendit të tij të punës.

25. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 10, datë 1.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke i marrë në analizë veprimet e mësipërme të debitorit, Gjykata vlerëson se ai ka pasur vullnetin për të ekzekutuar detyrimin që rridhte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, por mosekzekutimi ka ardhur si pasojë e vërtetimit të rrethanave të tjera. Për më tepër, nga materialet bashkëlidhur kërkesës, rezultojnë se debitori ka respektuar të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil, duke e kaluar kërkuarin në listë pritjeje dhe duke kryer edhe pagesën e pagës së tij për këtë periudhë. Në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës, subjekti i interesuar është shprehur se rikthimi i kërkuarit ka qenë i pamundur, pasi jo vetëm që vendi i tij (një jurist) është suprimuar, por edhe se ai nuk plotëson kërkesat që kërkojnë pozicionet e tjera të punës të parashikuara në organikën e re të institucionit.

26. Për më tepër, Gjykata vlerëson se ligjshmëria e urdhrin nr. 23, datë 31.7.2012 të KSHB-së, për lirin e kërkuarit nga detyra dhe kalimin e tij në listë pritjeje, është bërë objekt kontrolli si nga ana e KSHC-së, në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ashtu edhe nga gjykata. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se me vendimin nr. 179, datë 18.10.2012, KSHC-ja ka rrëzuar ankimin e kërkuarit, duke vlerësuar se akti administrativ i kundërshtuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Me vendimin nr. 4532, datë 25.4.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar.

27. Për sa i përket detyrimit për pagesën e pagës për periudhën e qëndrimit pa punë, Gjykata ka theksuar se argumentet lidhur me mungesën e fondeve, janë të

pamjaftueshme dhe nuk justifikojnë mospagimin e detyrimit. Kërkesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga rezultati i favorshëm i procesit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit dhe se një vonesë në ekzekutim mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate (*shih vendimet nr. 48, datë 26.7.2012; nr. 17, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, në disa raste, kur ka shqyrtuar kërkesa individuale për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt, është vënë përballë pretendimeve të organeve shtetërore debitore për ekzekutimin me grafik të detyrimeve, duke e paraqitur si argument për të provuar vullnetin e tyre për ekzekutimin. Ajo ka vlerësuar se, pavarësisht se detyrimi ka filluar të ekzekutohet, mënyra dhe masa e ekzekutimit të tij, i caktuar në mënyrë të njëanshme prej organit të pushtetit publik, është joproporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustificuar në raport me vetë masën e plotë të vlerës së detyrimit në favor të kërkesit, gjë e cila cenon në vetvete thelbin e kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 42, datë 19.7.2012; nr. 48, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se detyrimi që debitori ka ndaj kërkesit është në vlerën 1 704 040 lekë. Gjykata vlerëson se debitori ka kryer disa veprime që të krijojnë bindjen se ka pasur vullnetin për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Fillimisht, debitori ka përcaktuar një grafik për ekzekutimin e detyrimit, në masën 12 500 lekë/muaj, dhe ka nisur ekzekutimin, sipas këtij grafiku, që prej muajit shtator 2012 e në vijim. Deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë në Gjykatë, rezulton që shuma e shlyer në favor të kërkesit ishte në masën 200 000 lekë. Në parashtrimet e datës 24.12.2013, subjekti i interesuar, KSHB-ja, ka informuar Gjykatën se në fund të vitit buxhetor 2013, institucionit i teproi një shumë e konsiderueshme fondesh dhe, me miratimin edhe të Ministrisë së Drejtësisë për përdorimin e tij, ka likuiduar me këtë fond kërkesin Maliq Maliqi në vlerën 972 000 lekë (*e provuar me urdhër shpenzimi nr. 166, datë 20.12.2013*). Në këto kushte, Gjykata vëren se detyrimi që subjekti i interesuar KSHB-ja ka ndaj kërkesit është shlyer në masën 1 172 000 lekë, pra afërsisht 70% e detyrimit, dhe mbetet për t'u shlyer nga debitori edhe një diferencë prej 532 040 lekësh.

29. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se vetëm fakti që autoritetet shtetërore kanë zbatuar vendimin, pas një vonese thelbësore, nuk mund të konsiderohet se i heq kërkesit statusin e personit, të cilit i është cenuar një e drejtë, në kuptimin kushtetues dhe se shlyerja e vonuar e detyrimit, nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, nuk mundet të riparojë mosveprimin e

organeve shtetërore për të zbatuar, për një periudhë të gjatë, vendimet e gjykatave (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, në vendimin për pranueshmërinë, të datës 17.9.2002 (*në çështjen Vasyl Petrovych Krapyvnytskyi kundër Ukrainës*), GJEDNJ-ja vlerësoi se një afat prej 2 vjet e 7 muaj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nuk konsiderohej i paarsyeshëm për kërkesat e nenit 6/1 të Konventës, në rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, që i referohej mungesës së fondeve të njësisë ushtarake debitore.

30. Në këto kushte, bazuar në argumentet e paraqitura më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, është haptazi i pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

#### MENDIM PAKICE

1. Mendojmë se kërkesa e kërkesit, duhej pranuar pjesërisht në lidhje me konstatimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.100, datë 15.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, sa i përket kthimit në vendin e mëparshëm të punës.

2. Shumica, kur ka marrë në analizë sjelljen e autoriteteve shtetërore, përkatësisht të KSHB-së, është shprehur se: *Në lidhje me sjelljen e debitorit KSHB, rezulton se në momentin e dhënies së vendimit nr. 93, datë 25.5.2010 të KSHC-së (për rikthimin e kërkesit në vendin e mëparshëm të punës), në organikën e këtij institucioni, sipas urdhrin nr. 96, datë 23.7.2008 të Kryeministrit, përfshihej një vend pune si jurist. Me urdhrin nr. 113, datë 31.12.2011 të Kryeministrit, është miratuar organika e re e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, duke përcaktuar 8 punonjës në përbërje të tij, ku u përfshinë dy juristë. Sipas*

*parashtrimeve të subjektit të interesuar, në vendin e ri të parashikuar në organikë është emëruar një jurist tjetër, duke u ruajtur i lirë vendi i kërkuarit deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Megjithatë, debitori i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, dhe ky i fundit nuk është ekzekutuar në lidhje me këtë pjesë të detyrimit. Masa e pezullimit ka qëndruar në fuqi deri në datën 5.4.2012, kur është dhënë vendimi i mospranimit nga ana e Kolegjit Civil, kurse me Urdhrit nr. 75, datë 2.7.2012 të Kryeministrit, është miratuar organika e re e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, duke u përcaktuar në përbërje të tij vetëm një pozicion pune si jurist. Në këto kushte, kërkuari është kaluar në listë pritjeje për shkak të deklarimit të tepërt të vendit të tij të punës” (prg. 24 i vendimit).*

3. Nuk kemi të njëjtin mendim në raport me sjelljen e KSHB-së dhe analizën e bërë për qëndrimin e këtij institucioni ndaj së drejtës së kërkuarit për rikthim në punë, të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe, për këtë arsye, do të parashtrijmë argumentet për sa vijon.

4. Siç rezulton nga rrethanat e çështjes, kërkuari është larguar nga pozicioni i juristit pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve. Ai është ankuar pranë KSHC-së, e cila, me vendimin nr. 93, datë 25.5.2010, ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 9 prot., datë 21.1.2010, *kthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës*, jurist pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve, si dhe detyrimin e këtij institucioni për të bërë pagesën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi. Vendimi nr. 93, datë 25.5.2010 i KSHC-së, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 100, datë 15.10.2010. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga KSHB-ja. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-790, datë 5.4.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Nga faktet rezulton se deri në datën 5.4.2012, kur është dhënë vendimi i mospranimit nga ana e Kolegjit Civil, në institucion mund të punësoheshin dy juristë, sipas urdhrin nr. 113, datë 31.12.2011 të Kryeministrit, me të cilin ishte miratuar organika e KSHB-së, me 8 punonjës në përbërje të tij, mes të cilëve dy juristë. Me urdhrin nr. 75, datë 2.7.2012 të Kryeministrit, është miratuar organika e re e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, duke u përcaktuar në

përbërje të tij vetëm një pozicion pune si jurist. KSHB-ja, për periudhën 5.4.2012- 2.7.2012, në kushtet kur kërkuari kishte fituar të drejtën të kthehej në vendin e mëparshëm të punës, me vendim gjyqësor të formës së prerë, dhe institucioni, sipas urdhrin nr. 113, datë 31.12.2011 të Kryeministrit, me organikë gjatë kësaj kohe kishte të përcaktuar në përbërje të tij dy juristë, mund ta ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit, sepse përveç juristit që kishte të punësuar, kishte edhe një vend të lirë pune për jurist që mund t'ia ofronte kërkuarit. Urdhri i Kryeministrit nr. 75, për organikën e re të institucionit, ku parashikohej të kishte vetëm një pozicion juristi, është miratuar disa muaj pasi debitori është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit. Në këto kushte nuk ka pasur asnjë pengesë për rikthimin e kërkuarit në vendin e mëparshëm të punës, pra vendimi i Gjykatës së Apelit ka qenë i ekzekutueshëm. Këtë e konfirmon dhe fakti që gjatë periudhës 5.4.2012 - 2.7.2012, përmbaruesi gjyqësor privat, me shkresën nr. 105/1 prot., datë 28.5.2012, i është drejtuar debitorit me lajmërim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Ndërkohë që me vendimin nr. 105/4 prot., datë 21.9.2012, përmbaruesi gjyqësor ka vendosur edhe të gjobisë kreun e institucionit debitor për shkak të pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë sa i përket moskryerjes së asnjë pagese në emër të kreditorit, si dhe mosrikthimit në vendin e mëparshëm të punës.

6. Për rrjedhojë, kërkuari nuk duhej kaluar në listë pritjeje, por KSHB-ja duhej t'ia ofronte kërkuarit rikthim në vendin e mëparshëm të punës, duke treguar vullnet për të ekzekutuar detyrimin që buronte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, pavarësisht zhvillimeve të mëvonshme organizative-strukturore të institucionit me daljen e urdhrin të Kryeministrit nr. 75 për organikën e re.

7. Përfundimisht, mendojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar pjesërisht vetëm për konstatimin e procesit të parregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 100, datë 15.10.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në pjesën ku nuk është realizuar rikthimi në vendin e mëparshëm të punës, në kushtet kur kishte mundësi të realizohej kjo pjesë e dispozitivit të vendimit nga KSHB-ja.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006